

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Drejtimin Mësimor

DETARI

Niveli III
(1 vjeçar)

Kodi: J-III-18

Miratoi:

MINISTRI

Tiranë, 2018

Përmbajtja:

I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin “Detari”, niveli III.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Detari”, niveli III.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në drejtimin “Detari”, niveli III.
2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Detari”, niveli III.
3. Kompetencat profesionale të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Detari”, niveli III.
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Detari”, niveli III.

III. Plani mësimor për drejtimin “Detari”, niveli III.

IV. Udhëzime për planin mësimor.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Detari”, niveli III.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.

I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin “Detari”, niveli III.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në drejtimin “Detari”, niveli III, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me sektorin e detarisë si dhe për të vijuar arsimin dhe formimin në nivele më të larta”*. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt formimit profesional dhe arsimit të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse dhe menaxhuese, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale dhe akademike;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Detari”, niveli III.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në drejtimin “Detari”, niveli III.

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në drejtimin “Detari”, niveli III. kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në një nga profilet e nivelit II të drejtimin mësimor “Detari”;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- në rastet kur kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim arsimit profesional në drejtimin “Detari”, niveli III.

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Detari”, niveli III, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.

- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale dhe ndërkombëtare.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse e menaxhuese për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll dhe përshtatshmëri gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënësve të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Detari”, niveli III.

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Detari”, niveli III, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në njërin nga profilet mësimore të nivelit II, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të hartojë një plan-bisnesi që lidhet me veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të kryejë menaxhimin e burimeve njerëzore, materiale dhe financiare gjatë veprimtarive profesionale përkatëse.
- Të interpretojë, plotësojë dhe përgatisë dokumentacion që lidhen me veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të zbatojë bazën ligjore që i referohet veprimtarive profesionale përkatëse.
- Të zbatojë standardet teknike të profesionit përkatës.
- Të zbatojë parimet e etikës gjatë ushtrimit të veprimtarive profesionale përkatëse.
- Të interpretojë standardet, kërkesat dhe zbatimin e legjislacionit vendas, konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare në sektorin e detarisë.
- Të realizojë hetime të incidenteve detare dhe hartojë raporte.
- Të interpretojë policat e siguracioneve detare për sektorin e detarisë;
- Të zbatojë kërkesat, udhëzimet dhe bashkëpunojë në zbatim të planit kombëtar të reagimit në raste ndotjesh detare nga hidrokarbure.
- Të interpretojë elementët konstruktivë në funksion të ruajtjes së stabilitetit dhe lundrueshmërisë së mjetit përfshirë në raste dëmtimi.
- Të interpretojë rregullat e shmangies së përplasjes, trafikut detar, sinjalistikës lundrimore.
- Të zbatojë teknikat e manovrimit, përfshirë në raste emergjence, kërkim-shpëtimi.
- Të zbatojë rregullat dhe standartet e komunikimit detar.
- Të zbatojë teknikat për kërkimin e tufave të peshkut në det.
- Të përdorë sekstantin dhe korigjojë busllën magnetike.

- Të zbatojë normat e reagimit sipas kërkesave të standartit të IMO-s “Për përdorimin e mjeteve të mbijetesës dhe shpëtimit, përjashtuar mjetet e shpejta të shpëtimit” Nr. 1.23.
- Të realizojë punime mirëmbajtëse riparuese të paisjeve dhe agregateve në mjetin e lundrimit.
- Të hartojë dokumentet e krijimit dhe organizimit të një biznesi në detari dhe akuakulturë, si dhe te rekrutimit të personelit.
- Të kryejë procedurat e blerjes dhe shitjes së ndërmarrjes ushqimore, në kushtet e një tregu konkurrues, si dhe të dokumentojë këto blerje dhe shitje.
- Të kryejë kontabilizime të thjeshta të një biznesi detarie dhe akuakulture.
- Të kryejë promocionin e imazhit të detarisë dhe akuakulturës gjatë aktivitetit të saj si dhe gjatë pjesëmarrjes në panairë.
- Të përdorë teknologjinë e informimit dhe komunikimit për qëllime të profesionit përkatës.
- Të përdorë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet dhe materialet e punës.
- Të kryejë saktë veprimet kryesore për të dhënë ndihmën e shpejtë.
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtjshëm në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Detari”, niveli III.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në drejtimin “Detari”, niveli III, e pajis nxënësin me Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale dhe me Çertifikatën e teknikut në Detari, si dhe mbas një përvoje pune në det me anijet dhe në sektorin përkatës, jo më pak se dymbëdhjetë (12) muaj, nxënësi fiton të drejtën për t’u pajisur nga Administrata Detare edhe me Çertifikatën e kualifikimit si zv. Kapiten në anije Peshkimi Rreg. II/4 dhe/ose mekanik Shërbimi në anije peshkimi Rr. II/5 sipas Konventës Ndërkombëtare të STCW-’95ⁱ dhe/ose Marinar Kuverte Rreg. II/5 dhe/ose Motorist Rreg. III/5 sipas Konventës Ndërkombëtare të STCW’78ⁱⁱ e ndryshuar. Ky arsimim i jep mundësi nxënësit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në një:

- mjet lundrimi për qëllime tregtare;
- mjet lundrimi mbi 24 m gjatësi për qëllime peshkimi;
- mjet lundrimi të shërbimit portual;
- mjet lundrimi bregdetar të agjensive të zbatimit të ligjit në det;
- stabiliment të mbledhjes dhe/ose përpunimit të produkteve ujore;
- mjet lundrimi për qëllime kënaqësie të lundrimit bregdetar;
- mjet lundrimi bregdetar për qëllime kërkimore-shkencore;
- pikë shërbimi mirëmbajtje dhe riparimi për veglat e peshkimit;
- fermë të rritjes artificiale në ujërat e ëmbla, njelmëta ose bregdet;

Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimit në nivelin pas të mesëm ose në nivelin e studimeve universitare.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në drejtimin mësimor “Detari”, niveli III.

Plani mësimor për drejtimin “Detari”, niveli III.			
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/ vjetore
			Klasa 13
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	15/17 (480/544)
1		Gjuhë shqipe dhe letërsi	2
2		Gjuhë e huaj	2
3		Gjuhë e huaj 2 (me zgjedhje të lirë)	(2)
4		Histori	2
5		Gjeografi	2
6		Matematikë	2
7		Biologji	2
8		Teknologji informimi e komunikimi	1
9		Lëndë me zgjedhje të detyruar (Fizikë; Kimi; Biologji; Histori arti)	2
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	9 (288)
1	L-17-197-11	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-05-198-12	Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm	1
3	L-30-465-18	Ligjshmëri dhe organizim në detari	2
4	L-30-466-18	Lundrim detar	3
5	L-24-467-18	Elektromekanika në anije	1
C.		Module të detyruar të praktikës profesionale (Gjithsej)	6 (192)
1	M-30-1410-18	Lundrim detar me anije	63
2	M-30-1411-18	Aftësimi në mjetet e mbijetesës dhe të shpëtimit, përjash-tuar mjetet e shpejta të shpëtimit (IMO 1.23)	33
3	M-30-1412-18	Shërbime mirëmbajtëse elektromekanike në anije	33
4	M-17-1413-18	Krijimi, organizimi i veprimtarisë së ndërmarrjes për zënie/kultivim të produkteve ujore	33
4	M-17-1414-18	Promocioni dhe veprime të shit-blerjes së produkteve ujore	30
		Gjithsej A+B+C	30/32 (960/ 1024)

IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 13, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (32 javë mësimore + 4 javë provime).

Një javë mësimore ka jo më shumë se 32 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në drejtimin “Detari”, niveli III, përbëhet nga 3 grupe

elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASR).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave profesionale dhe menaxheriale, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që **planifikimi i mësimdhënies** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i personelit mësimdhënës e drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkollën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të drejtimit mësimor “Detari”, niveli III.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi. Rekomandohet përdorimi i metodës së “*lojës me role*”, ku nxënësve tu jepen përgjegjësi në kryerjen e funksioneve menaxhuese dhe drejtuese.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të drejtimit profesional “Detari”.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet përfundimtare.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe

në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 13-të, nxënësi i arsimuar në drejtimin mësimor “Detari”, niveli III, i nënshtrohet provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale (sipas udhëzimeve të MASR dhe MFE) si dhe Provimit të Praktikës Profesionale të Integruar (sipas udhëzimeve të MFE).

VII. Të dhëna për çertifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Detari”, niveli III.

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Detari”, niveli III, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, si dhe me Çertifikatën teknikut në Detari, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modeleve të miratuara nga MASR dhe MFE, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
 - rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale të klasës 13-të;
 - rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale dhe të Praktikës Profesionale të Integruar.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-197-11) Kl. 13 – 64 orë

- Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë lidhjen dhe ndryshimin midis sipërmarrjes dhe menaxhimit
- Të shpjegojnë kuptimin filozofik të kompanisë dhe misionin e saj në tregun e biznesit.
- Të përshkruajnë aktivitetet e biznesit të kryera nga sipërmarrësit në menaxhimin e biznesit.
- Të fitojnë aftësitë themelore dhe teknikat për të udhëhequr dhe menaxhuar një biznes në kontekst të kërkesave aktuale shoqërore.
- Të dallojnë tiparet dhe aftësitë menaxheriale që lidhen me punën e suksesshme sipërmarrëse.
- Të shpjegojnë funksionet dhe teknikat e menaxhimit.
- Të shpjegojnë kuptimin dhe nevojën për menaxhimin e burimeve njerëzore (personelit).
- Të menaxhojnë stafin profesional, duke promovuar talentet dhe zhvillimin e mundësive të karrierës
- Të dallojnë konceptet, sistemet, dhe mjetet e nevojshme për sigurimin, ruajtjen, vlerësimin dhe shpërndarjen e informacionit për vendim-marrjen në biznes.
- Të shpjegojnë nevojën e vlerësimit të tregut dhe dobinë e marketingut në biznes, si dhe mënyrën për të arritur objektivat e tij.
- Të shpjegojnë konceptet financiare dhe mjetet e përdorura për menaxhimin financiar.
- Të hartojnë një plan efektiv biznesi sipas profilit përkatës.
- Të përshkruajnë procesin e financimit nëpërmjet krijimit të planit të biznesit dhe analizën e burimeve të financimit.
- Të vlerësojnë qëndrueshmërinë ekonomike për të ardhmen e kompanisë.
- Të dallojnë kuadrin ligjor dhe detyrimet përkatëse si pjesë aktive e vendimarrjes në një biznes.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13 - 64 orë

Tema 1	Sipërmarrja dhe menaxhimi	4 orë
Tema 2	Sipërmarrja dhe biznesi	5 orë
Tema 3	Aftësitë menaxheriale	6 orë
Tema 4	Funksionet dhe teknikat e menaxhimit	5 orë
Tema 5	Menaxhimi i burimeve njerëzore	7 orë
Tema 6	Menaxhimi i informacionit	6 orë
Tema 7	Menaxhimi marketing	5 orë
Tema 8	Menaxhimi financiar	6 orë
Tema 9	Zhvillimi i një plani biznesi	8 orë
Tema 10	Objektivat e biznesit dhe treguesit e menaxhimit	7 orë
Tema 11	Kuadri ligjor dhe taksat	5 orë

2. Lënda “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm” (L-05-198-12). Kl.13 – 32 orë

• Synimet e lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë kuptimin për “mjedisin” dhe “mbrojtjen e mjedisit”.
- Të shpjegojnë kuptimin për “zhvillimin e qëndrueshëm”
- Të tregojnë se si ndikon veprimtaria e njeriut në mjedisin rrethues.
- Të përshkruajnë burimet kryesore të mjedisit jetësor.
- Të analizojnë marrëdhëniet midis zhvillimeve demografike dhe mjedisit jetësor.
- Të tregojë dhe japin shembuj të ndikimit të mbetjeve në mjedisin jetësor
- Të përshkruajnë mekanizmat e monitorimit të burimeve mjedisore.
- Të përshkruajnë kuadrin ligjor dhe institucional ndërkombëtar, kombëtar dhe vendor në lidhje me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm
- Të përshkruajnë sistemet e menaxhimit të mjedisit.
- Të hulumtojnë dhe analizojnë problemet mjedisore në mjedisin vendor.
- Të planifikojnë dhe realizojnë veprimtari praktike për mbrojtjen e mjedisit vendor.

• Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl.13 - 32 orë

Tema 1	Njohuri të përgjithshme për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm	2 orë
Tema 2	Burimet kryesore të mjedisit dhe degradimi mjedisor	3 orë
Tema 3	Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në mjedis	3 orë
Tema 4	Zhvillimet demografike dhe mjedisi	3 orë
Tema 5	Shoqëria e konsumit dhe mbetjet	4 orë
Tema 6	Monitorimi i burimeve mjedisore	3 orë
Tema 7	Kuadri ligjor dhe institucional për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm	2 orë
Tema 8	Sistemet e menaxhimit të mjedisit	3 orë
Tema 9	Veprimtari praktike për analizën e problemeve dhe planifikimin e nismave mjedisore në nivel lokal	3 orë
Tema 10	Veprimtari praktike për mbrojtjen e mjedisit lokal	6 orë

3. Lënda “Ligjshmëri dhe organizim në detari” (L-30-465-18). Kl. 13 – 32 orë

• Synimet e lëndës “Ligjshmëri dhe organizim në detari”, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Ligjshmëri dhe organizim në detari”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të përkufizojnë të drejtat dhe detyrat e ngarkuara nga legjislacioni, institucioneve, autoriteteve dhe aktorëve të tjerë me interesa në hapësirën detare të Republikës së Shqipërisë.
- Të përshkruajnë funksionet e Regjistrit të Mjeteve Lundruese dhe Detarëve;
- Të përshkruajnë funksionet e Shoqërisë së Klasifikimit të mjeteve lundruese;
- Të përshkruajnë fushën e zbatimit dhe objektivat e konventave kryesore që kanë lidhje me sigurinë detare dhe mbrojtjen e mjedisit detar të OKB-së, IMO-s, ILO-s, FAO-s,

WHO-s, si dhe të Direktivave kryesore të BE-së.

- Të përshkruajnë fushën e zbatimit dhe objektivat e marëveshjeve ndërkufitare dhe rajonale të R. Sh. me shtetet fqinje dhe të rajonit që kanë lidhje me shfrytëzimin e hapësirës detare;
- Të përkufizojnë qëllimin dhe objektivat e kodit të menaxhimit të përgjegjshëm për peshkimin të FAO-s.
- Të përshkruajnë udhëzimet teknike të peshkimit të përgjegjshëm të FAO-s.
- Të përshkruajnë parimet kryesore të hetimit të aksidenteve dhe incidenteve detare, procedurat e reagimit dhe evidencat e nevojshme për hetim sipas Kodit të IMO-s.
- Të përshruajnë parimet kryesore, llojet dhe kushte nga policat e siguracioneve detare në përgjithësi për mjete të ndryshme lundrimi.
- Të përshkruajnë qëllimin, objektivat, procedurat dhe aktorët që përfshihen në raste të ndotjeve masive në det në R. Sh. sipas Planit Kombëtar të Reagimit.
- Të tregojnë prioritetet, vizionin dhe objektivat e planit kombëtar të transportit për sektorin detar, strategjinë e peshkimit dhe të produkteve ujore.
- Të tregojnë llojet dhe organizimet e subjekteve detare dhe të produkteve ujore dhe dispozitat ligjore për funksionimin e tyre.
- Të përkufizojnë nocionin e tregut.
- Të shpjegojnë kërkesën dhe ofertën e shërbimeve në det dhe të produkteve ujore.
- Të identifikojnë faktorët ndikues në sektorin e detarisë dhe të produkteve ujore.
- Të tregojnë procedurat e hapjes së në biznesi të ri.
- Të tregojnë format e garantimit të cilësisë, standardeve dhe funksionimit të kodit të etikës në sektorin detar dhe të produkteve ujore.
- Të shpjegojnë politikat fiskale që funksionojnë në sektorin detar dhe të produkteve ujore.
- Të analizojnë ndikimet e zhvillimit të gjuetisë dhe produkteve ujore në teknologjinë ushqimore.
- Të përshkruajnë forma të ndryshme të marketingut në sektorin e produkteve ujore.
- Të përshkruajnë të drejtat që ka konsumatori gjatë blerjes së produkteve ujore, pasqyruar kjo në legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Të analizojë format e ndryshme të mbikqyrjes së tregut të produkteve ujore.
- Të përshkruajnë procedurat dhe kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojë ndërmarrja për të eksportuar dhe/ose importuar produktet ujore.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Ligjshmëri dhe organizim në detari”, kl.13 - 64 orë**

Tema 1	Organizimi, kontrolli e ligjshmëria e hapësirës detare	4 orë
Tema 2	Regjistri i mjeteve lundruese dhe detarëve	2 orë
Tema 3	Shoqëria e Klasifikimit të mjeteve lundruese	2 orë
Tema 4	IMO, ILO, FAO, OKB, BE, Marëveshje Rajonale & Ndërkufitare	7 orë
Tema 5	Kodi menaxhimit të përgjegjshëm në peshkim FAO	2 orë
Tema 6	Udhëzimet Teknike për peshkim të përgjegjshëm	3 orë
Tema 7	Kodi i Hetimit të Aksidenteve & Incidenteve Detare të IMO-s	4 orë
Tema 8	Siguracioni Detar	5 orë
Tema 9	Plani Kombëtar i reagimit ndaj ndotjeve masive detare	3 orë
Tema 10	Legjislacioni në sektorin detar dhe kultivimit të produkteve ujore	4 orë
Tema 11	Subjektet ofruese shërbimi dhe prodhuese. Dispozitat e përgjithshme	3 orë

	për aktivitetin e tyre dhe për produktet ujore.	
Tema 12	Tregu i produkteve ujore	3 orë
Tema 13	Tregu i faktorëve të prodhimit në sektorin detar/kultivimin artificial	3 orë
Tema 14	Hapja e një biznesi në sektorin detar dhe kultivimit të produkteve ujore	4 orë
Tema 15	Siguria ushqimore	2 orë
Tema 16	Politikat fiskale në sektorin detar/kultivimit të produkteve ujore	3 orë
Tema 17	Ndikimi i zhvillimit nga zënia dhe kultivimi artificial i produkteve ujore në industrinë ushqimore	2 orë
Tema 18	Marketingu në sektorin detar/kultivimit artificial të produkteve ujore	2 orë
Tema 19	Mbrojtja e konsumatorit dhe legjislacioni përkatës	2 orë
Tema 20	Mbikqyrja e tregut të produkteve ujore	2 orë
Tema 21	Bazat e eksportit dhe importit për produktet ujore	2 orë

4. Lënda “Lundrim detar” (L-30-466-13). Kl. 13 – 96 orë

- Synimet e lëndës “Lundrim detar”, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Lundrim detar”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të përshruajnë organizimin e punës, shërbimit dhe pushimit në anije.
- Të përshruajnë parimet dhe kushtet e sigurisë, jetesës dhe higjenes në anije sipas standarteve të IMO-s, FAO-s dhe ILO-s.
- Të interpretojnë sinjalet dhe simbolet e Kodit Ndërkombëtar të Sinjaleve të IMO-s.
- Të interpretojnë rregullat e parandalimit të përplasjeve në det.
- Të interpretojnë rregullat në lidhje me organizimin e trafikut detar të IALA-s.
- Të përshkruajnë parimet, materialet dhe teknikat e ndërtimit të anijeve.
- Të përshkruajnë faktorët ndikues dhe masat për ruajtjen e stabilitetit të anijes në raste dëmtimesh.
- Të përshkruajnë teknikat për manovrimin dhe përdorimin e anijes në të gjithë kushtet përfshirë dhe në raste emergjence.
- Të përshkruajnë instrumentat, teknikat dhe shenjat rrethore të vlefshme për kërkimin e tufave të peshkut në det.
- Të përshkruajnë metodat, mjetet dhe kushtet për korrigjimin e busullës magnetike të anijes.
- Të përshkruajnë ndërtimin, funksionin, përdorimi dhe mirëmbajtja e sekstantit;
- Të përshkruajnë parimet e punës dhe tiparet e shërbimeve të Sistemit Global të Komunikimit për Rreziqet dhe Sigurinë në Det (IMO Model 1.26).
- Të përshkruajnë veprimet reaguese ndaj një mesazhi emergjence të natyrës kërkim-shpëtimi.
- Të përshkruajnë legjislacionin, rregullat, shërbimet dhe institucionet përkatëse për komunikimin në det.
- Të përshkruajnë veprimet dhe masat për komandimin e një mjeti mbijetese pas braktisjes së anijes (IMO Model 1.23).
- Të përshkruajnë hapat për ndezjen dhe përdorimin e motorrit shtytës të mjetit të mbijetesës.
- Të përshkruajnë masat për menaxhimin e të mbijetuarve pas braktisjes së anijes.
- Të përshkruajnë veprimet për sinjalizimin e vendodhjes së mjetit të mbijetesës.
- Të përshruajnë masat dhe mjetet për dhënie të ndihmës së parë të mbijetuarve.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Lundrim detar”, kl.13 - 96 orë**

Tema 1	Organizim i punës, shërbimit dhe pushimit në bord IMO, FAO & ILO	6 orë
Tema 2	Kodi i sigurisë së peshkatarëve dhe anijeve të peshkimit IMO, FAO	4 orë
Tema 3	Kodi Ndërkombëtar i sinjaleve të IMO-s	6 orë
Tema 4	Rregullat e Parandalimit të Përplasjeve në Det (REPAD)	10 orë
Tema 5	Shoqata Ndërkombëtare e Ndihmuesve Detar për Lundrimin dhe Autoritetet e Fenerëve Detar (IALA)	8 orë
Tema 6	Ndërtimi, stabiliteti dhe kontrolli i tij në raste dëmtimesh	12 orë
Tema 7	Manovrim anije	6 orë
Tema 8	Metodat e kërkimit të peshkut në det	2 orë
Tema 9	Korigjimi i busullës magnetike, sekstanti	4 orë
Tema 10	Komunikimi detar, legjislacioni dhe institucionet (IMO Model 1.26)	14 orë
Tema 11	Kërkim shpëtimi në det	4 orë
Tema 12	Aftësim në përdorimin e Mjetit të Mbijetesës & Mjetit të Shpëtimit përjashtuar Mjetet e Shpejta të Shpëtimit (IMO Model 1.23) Kontrolli i mjetit të mbijetesës pas braktisjes së anijes	4 orë
Tema 13	Aftësim në përdorimin e Mjetit të Mbijetesës & Mjetit të Shpëtimit përjashtuar Mjetet e Shpejta të Shpëtimit (IMO Model 1.23) Operim i motorrit të mjetit të mbijetesës	4 orë
Tema 14	Aftësim në përdorimin e Mjetit të Mbijetesës & Mjetit të Shpëtimit përjashtuar Mjetet e Shpejta të Shpëtimit (IMO Model 1.23) Menaxhimi i të mbijetuarve dhe mjetit pas braktisjes së anijes	4 orë
Tema 15	Aftësim në përdorimin e Mjetit të Mbijetesës & Mjetit të Shpëtimit përjashtuar Mjetet e Shpejta të Shpëtimit (IMO Model 1.23) Përdorimi i paisjeve lokalizuese, komunikuese dhe sinjalizuese	4 orë
Tema 12	Aftësim në përdorimin e Mjetit të Mbijetesës & Mjetit të Shpëtimit përjashtuar Mjetet e Shpejta të Shpëtimit (IMO Model 1.23) Dhënia e ndihmës së parë të mbijetuarve	4 orë

5. Lënda “Elektromekanika në anije” (L-30-467-18). Kl. 13 – 32 orë

• **Synimet e lëndës “Elektromekanika në anije”, kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Elektromekanika në anije”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të përkufizojnë parimet bazë të inxhinjerisë në operimin e sistemeve të anijes;
- Të tregojnë punimet mirëmbajtëse që kryhen motorëve detar;
- Të tregojnë punimet mirëmbajtëse që kryhen makinerisë ndihmëse përfshirë pompa, tubacione, kaldaja, sisteme drejtimi, etj.
- Të tregojnë punimet mirëmbajtëse që kryhen impianteve të energjisë në anije;
- Të tregojnë punimet mirëmbajtëse që kryhen sistemeve të ftohjes në anije;
- Të tregojnë punimet mirëmbajtëse që kryhen sistemeve hidraulike, paisjeve të gjuetisë dhe agregateve të kuvertës;
- Të tregojnë punimet mirëmbajtëse dhe testet që kryhen paisjeve elektrike në anije;
- Të tregojnë punimet mirëmbajtëse dhe testet që kryhen paisjeve të kontrollit dhe komandimit;

- Të tregojnë punimet mirëmbajtëse që i kryhen motorrëve jashtë-bordit;
- Të përshkruajnë veprimet, masat dhe evidencat gjatë kryerjes së shërbimit në lokalin e makinerisë në lundrim, qëndrim në port apo spirancë;

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Elektromekanika në anije”, kl.13 - 32 orë**

Tema 1	Parimet teorike bazë të inxhinierisë në operimin e sistemeve të anijes	6 orë
Tema 2	Mirëmbajtja e motorrëve detar	3 orë
Tema 3	Mirëmbajtja e makinerisë ndihmëse përfshirë pompa, tubacione, kaldaja, sisteme drejtimi, etj.	5 orë
Tema 4	Mirëmbajtja e impianteve të energjisë	3 orë
Tema 5	Mirëmbajtja e sistemeve të ftohjes	2 orë
Tema 6	Mirëmbajtja e sistemeve hidraulike, paisje gjuetie e agregate kuverte	3 orë
Tema 7	Mirëmbajtja dhe testimi i paisjeve elektrike	3 orë
Tema 8	Mirëmbajtja dhe testimi i paisjeve të kontrollit	3 orë
Tema 9	Mirëmbajtja e motorrëve jashtë-bordit	2 orë
Tema 10	Kryerja e shërbimit në lundrim në lokalin e makinerisë	2 orë

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

1. Moduli “Lundrim detar me anije”

Drejtimi: Detari

Niveli: III

Klasa: 13

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe Kodi	LUNDRIM DETAR ME ANIJE	M-30-1410-18
Qëllimi i odulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer veprimtari praktike në lundrim në pozita të planifikimit, organizimit, përfshirjes së drejtpërdrejt në manovra, raportimit, vlerësimit e të tjera veprimtari në funksion të një lundrimi të sigurtë.	
Kohëzgjatja e modulit	63 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kl.12 në një nga profilet e niv.II të drejtimit mësimor “Detari”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi kryen manovra të ç’akostimit nga bankina të anijes Përmbajtja <ul style="list-style-type: none">- Sigurimi që përgatitja për lundrim në të gjithë aspektet ka përfunduar.- Sigurimi që ekuipazhi është në anije dhe në pozicione manovre si në kuvertë ashtu edhe në lokalin e makinerisë.- Sigurimi për marjen e masave për sigurinë, shëndetin dhe mbrojtjes së mjedisit.- Sigurimi që në bankinë ka njerëz profesionistë të njohur për heqjen e cimave nga kalunët e kalatës.- Vrojtim i rrethanave meteorologjike, kryesisht drejtimi dhe forca e erës.- Vlerësim të mënyrës së ç’akostimit në raport me efektet e erës, pozicionit të anijes së akostuar, mjeteve të tjera lundruese apo objekteve përreth.- Informimi i ekuipazhit në kuvertë për mënyrën e ç’akostimit.- Dhënia e komandës për ekuipazhin e kuvertës për vendosje gomash në pozicione të mundshme për takim me anije/objekte përreth.- Komunikimi me lokalin e makinerisë me zë dhe prove telegrafe për gatishmërinë për fillimin e manovrave.- Dhënia e komandës ekuipazhit të kuvertës/personave në kalatë për heqje të cimave sipas planit të ç’akostimit.- Dhënia e komandës lokalit të makinerisë me telegrafë për lëvizjen e motorrit për ç’akostim.- Ndjekja e manovrës në të gjithë aspektet e saj.- Sigurimi i cimave dhe i agregateve të përdour të kuvertës.	

- Raportimi Sallës së Kontrollit të Trafikut Detar për shkëputjen nga bankina dhe praninë në basenin portual për dalje nga porti.
- Raportimi Sallës së Kontrollit të Trafikut Detar për daljen nga porti.
- Dhënia e komandës për fillimin e lundrimit të lirë për ekuipazhin.
- Informimi ekuipazhit për orarin e shërbim/pushimit dhe orën e pritshme të mbërritjes në zonën e gjuetisë.
- Raportimi Kapitenit për konstatimet dhe kryerjen e detyrave.
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.
- Rregullat sigurimit teknik, mbrojtjes së mjedisit dhe mbrojtjes nga zjarri.
- Mirëmbajtja e vendit të punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të sigurohet për përfundimin e përgatitjes për lundrim në të gjithë aspektet;
- të sigurohet që ekuipazhi është në anije dhe në pozicione manovre si në kuvertë ashtu edhe në lokalin e makinerisë;
- të sigurohet që masat për sigurinë, shëndetin dhe mbrojtjes së mjedisit janë marrë;
- të sigurohet që në bankinë ka njerëz profesionistë të njohur për heqjen e cimave nga kalunët e kalatës;
- të interpretojë rrethanat meteorologjike, kryesisht drejtimi dhe forca e erës nga vrojtimi;
- të intereptojë mënyrën e ç'akostimit në raport me efektet e erës, pozicionit të anijes së akostuar, mjeteve të tjera lundruese apo objekteve përreth nga vlerësimet;
- të informojë ekuipazhin në kuvertë për mënyrën e ç'akostimit;
- të japë komandën për ekuipazhin e kuvertës për vendosje gomash në pozicione të mundshme për takim me anije/objekte përreth;
- të komunikojë me lokalin e makinerisë me zë dhe provë telegrafe për gatishmërinë për fillimin e manovrave;
- të japë komandën ekuipazhit të kuvertës/personave në kalatë për heqje të cimave sipas planit të ç'akostimit;
- të japë komandën lokalit të makinerisë me telegrafë për lëvizjen e motorrit për ç'akostim;
- të ndjekë manovrën në të gjithë aspektet e saj, në zbatim komande në kuvertë, në makineri, kontakte me mjete/objekte përreth, lëvizje të mjetit lundrues dhe efekteve të erës/detit mbi të;
- të kontrollojë për sigurimin e cimave dhe agregateve të përdour të kuvertës;
- t'i raportojë Sallës së Kontrollit të Trafikut Detar për shkëputjen nga bankina dhe praninë në basenin portual për dalje nga porti sipas rregullave të GMDSS;

- t'i raportojë Sallës së Kontrollit të Trafikut Detar për daljen nga porti sipas rregullave të GMDSS;
- të japë komandën për fillimin e lundrimit të lirë për ekuipazhin;
- të informojë ekuipazhin për orarin e shërbim/pushimit dhe orën e pritshme të mbërritjes në zonën e gjuetisë;
- të raportojë tek Kapitenit për konstatimet dhe kryerjen e detyrave;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat sigurimit teknik, mbrojtjes së mjedisit dhe mbrojtjes nga zjarri.
- të mirëmbajë pastër vendin e punës gjatë kryerjes së manovrave të ç'akostimit nga bankina të anijes.

RM 2 Nxënësi kryen korigjimin e busullës magnetike me objekte bregdetare me mbulim.

Përmbajtja

- Përzgjedhja e objekteve me mbulim të rekomanduar;
- Vlerësim i situatave meteorologjike të përshtatshme për korigjim busulle;
- Vlerësim i trafikut detar në zonën e poligonit ku do të bëhet korigjimi i busullës;
- Marja e shënimeve për informacionin e dhënë nga paisjet radio-navigacionale lidhur me kursin dhe pozicionin e anijes;
- Komunikimi me sallën e kontrollit të trafikut detar për manovra për qëllime të korigjimit të busullës magnetike;
- Vendosja dhe fiksimi i pelengatorit mbi busull;
- Përcaktimi i pelengut magnetik nga diferenca e pelengut të vërtetë me deklinacionin e dhënë nga harta;
- Planifikimi fillimit të manovrës sipas tetë drejtimeve kryesore të horizontit;
- Mbajtja e timonit saktë, preferueshëm me autopilot në katër drejtimet kryesore fillimisht dhe më pas në katër drejtimet e ndërmjetme të horizontit;
- Fillimi i lëvizjes sipas drejtimit të parë dhe marja e pelengut të objekteve me mbulim;
- Gjetja e shmangies nga krahasimi i pelengut të lexuar në busull në çastin e kalimit në nëpërvijë me atë magnetik të llogaritur;
- Përcaktimi i shmangies lindore kur pelengu i busullës del më i vogël se ai magnetik;
- Përcaktimi i shmangies perëndimore kur pelengu i busullës del më i madh se ai magnetik;
- Marja e shënimeve për çdo matje;
- Plotësimi i tabelës së shmangies me firmën e Kapitenit dhe vulën e anijes;
- Evidentimi i saj në afërsi të timonit dhe busullës në urën e komandës;
- Pastrimi i vendit dhe mjeteve të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së

mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë objektet me mbulim të rekomanduar duke bërë krahasime me përshkrimin në hartë;
- të interpretojë situatat meteorologjike të përshtatshme për korigjim busulle nga vlerësimet;
- të interpretojë rrethanat e trafikut detar në zonën e poligonit ku do të bëhet korigjimi i busullës nga vlerësimet;
- të shënojë me kujdes dhe qartë informacionin e marrë nga paisjet radio-navigacionale lidhur me kursin dhe pozicionin e anijes;
- të komunikojë sipas rregullave të GMDSS me sallën e kontrollit të trafikut detar për manovra për qëllime të korigjimit të busullës magnetike;
- të vendosë dhe fiksojë me kujdes pelengatorin mbi busull;
- të lexojë me kujdes pelengjet nga busulla dhe drejtimi i pelengatorit;
- të përcaktojë pelengun magnetik nga diferenca e pelengut të vërtetë me deklinacionin e dhënë nga harta;
- të planifikojë me kujdes fillimin e manovrës sipas tetë drejtimeve kryesore të horizontit;
- të mbajë timonin saktë, preferueshëm me autopilot në katër drejtimet kryesore fillimisht dhe më pas në katër drejtimet e ndërmjetme të horizontit;
- të japë komandën për fillimin e lëvizjes sipas drejtimit të parë dhe marja e pelengut të objekteve me mbulim;
- të përcaktojë shmangien nga krahasimi i pelengut të lexuar në busull në çastin e kalimit në nëpërvijë me atë magnetik të llogaritur;
- të përcaktojë shmangien si lindore kur pelengu i busullës del më i vogël se ai magnetik;
- të përcaktojë shmangien si perëndimore kur pelengu i busullës del më i madh se ai magnetik;
- të marë me kujdes dhe qartë shënimet për çdo matje;
- të plotësojë qartë dhe pa-gabime tabelën e shmangies, japë për firmë Kapitenit dhe vendosë vulën e anijes;
- të afishojë dukshëm tabelën e shmangies së busullës magnetike në afërsi të timonit dhe busullës në urën e komandës;
- të pastrojë vendin dhe mjetet e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryejës së korigjimit të busullës magnetike me objekte bregdetare me mbulim.

**RM 3 Nxënësi mat kënde horizontale dhe vertikale të objekteve bregdetare me sekstant për gjetjen e pozicionit të vendodhjes.
Përmbajtja**

Matja e këndeve horizontale

- Përzgjedhja e objekteve bregdetare për matje të këndeve;
- Përgatitja e sekstantit;
- Leximi i tabelës me shmangiet e nxjera nga kalibrimi i paisjes;
- Pozicionimi i sekstantit në një vend të përshtatshëm të palëvizshëm dhe horizontal;
- Drejtimi i gypit optik nga objekti bregdetar në të majtë;
- Lëvizja e alidadës me anë të mikrometrit për të “puthitur” objektin në të djathtë që shihet nga pasqyra me atë në të majtë që shihet nga pamja e drejtpërdrejtë;
- Leximi i këndit në fushën e harkut të shkallëzuar;
- Shënimi i këndit dhe i orës së saktë të matjes;
- Hedhja e këndit në hartë mbi majat e objekteve bregdetare;
- Gjetja e pozicionit të anijes në kulmin e këndit;
- Gjetja e zhvendosjes së pozicionit nga ai i llogaritur;

Matja e këndeve vertikale

- Përzgjedhja e objekteve bregdetare për matje të këndeve;
- Nxjerja e lartësisë së objekteve bregdetare nga leximi i hartës;
- Pozicionimi i sekstantit në një vend të përshtatshëm të palëvizshëm dhe vertikal;
- Drejtimi i gypit optik nga baza e objektit bregdetar të parë;
- Lëvizja e alidadës me anë të mikrometrit për të “puthitur” majën e objektin që shihet nga pasqyra me bazën e tij që shihet nga pamja e drejtpërdrejtë;
- Leximi i këndit në fushën e harkut të shkallëzuar;
- Shënimi i këndit dhe i orës së saktë të matjes;
- Matja e këndit vertikal të objektit të dytë;
- Shënimi i këndit dhe i orës së saktë të matjes;
- Gjetja e largësisë nga bazat e objekteve me të dhëna lartësinë e objekteve nga harta dhe këndet e matura;
- Hedhja në hartë me kompasin e hapur e dy rrrathëve me rreze sa largësia e gjetur nga bazat e objekteve përkatësisht;
- Gjetja e pozicionit të anijes në pikëprerjen e rrrathëve;
- Gjetja e pozicionit të anijes në kulmin e këndit;
- Gjetja e zhvendosjes së pozicionit nga ai i llogaritur;
- Hedhja e shënimeve në ditarin e lundrimit;
- Pastrimi i vendit dhe mjeteve të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

Për matjen e këndeve horizontale

- të përzgjedhë objektet bregdetare për matje të këndeve duke i krahasuar me të dhënat e hartës;
- të përgatisë me kujdes sekstantin (nxjerja nga kutia e ruajtjes, pastrimi me kujdes i pasqyrave, lenteve dhe xhamave, lenteve të gypit optik, harkut të shkallëzuar, mikrometrit, alidadës, etj.);

- të lexojë për referim në matjet aktuale të tabelës me shmangiet e nxjera nga kalibrimi i paisjes;
- të pozicionojë me kujdes sekstantit në një vend të përshtatshëm të palëvizshëm dhe horizontal;
- të drejtojë gypin optik nga objekti bregdetar në të majtë;
- të lëvizës ngadalë alidadën me anë të mikrometrit për të “puthitur” objektin në të djathtë që shihet nga pasqyra me atë në të majtë që shihet nga pamja e drejtpërdrejtë;
- të lexojë saktë këndin në fushën e harkut të shkallëzuar;
- të shënojë saktë dhe qartë këndin dhe orën e matjes;
- të hedhë saktë këndin në hartë të marë mbi majat e objekteve bregdetare;
- të përcaktojë vendodhjen e anijes në kulmin e këndit;
- të përcaktojë largësinë e zhvendosjes së pozicionit të matur nga ai i llogaritur;

Për matjen e këndeve vertikale

- të përzgjedhë objektet bregdetare për matje të këndeve duke i krahasuar me të dhënat e hartës;
- të përgatisë me kujdes sekstantit (nxjerja nga kutia e ruajtjes, pastrimi me kujdes i pasqyrave, lenteve dhe xhamave, lenteve të gypit optik, harkut të shkallëzuar, mikrometrit, alidadës, etj.);
- të lexojë për referim në matjet aktuale të tabelës me shmangiet e nxjera nga kalibrimi i paisjes;
- të pozicionojë me kujdes sekstantit në një vend të përshtatshëm të palëvizshëm dhe vertikal;
- të drejtojë gypin optik nga baza e objektit bregdetar të parë;
- të lëvizës ngadalë alidadën me anë të mikrometrit për të “puthitur” majën e objektit që shihet nga pasqyra me bazën e tij që shihet nga pamja e drejtpërdrejtë;
- të lexojë saktë këndin në fushën e harkut të shkallëzuar;
- të shënojë saktë dhe qartë këndin dhe orën e matjes së parë;
- të kryejë në të njëjtën mënyrë matjen e këndit vertikal të dytë;
- të shënojë saktë dhe qartë këndin dhe orën e matjes së dytë;
- të përcaktojë saktë largësitë nga bazat e objekteve me dhënat e lartësisë së tyre nga leximi i hartës dhe këndet e matura;
- të hedhë saktë me kompas rrathët me diametër gjatësitë e gjetura nga bazat e objekteve bregdetare;
- të përcaktojë vendodhjen e anijes në pikëprerjen e rrathëve;
- të përcaktojë largësinë e zhvendosjes së pozicionit të matur nga ai i llogaritur;
- të hedhë saktë dhe qartë shënimet në ditarin e lundrimit;
- të pastrojë vendin dhe mjetet e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 4 Nxënësi përdor pajisjet e radiokomunikimit detar të zonës A1 të instaluar në anije.

Përmbajtja

- Ndezja e radios VHF (very high frequency) të llojit DSC (digital selective call) të instaluar në anije;
- Transmetimi me anë të radios, në frekuencën (kanalin) e përcaktuar si:
 - njoftim kapitenerisë për nisje të mjetit lundrues për gjueti;
 - njoftim kapitenerisë për dalje nga porti të mjetit lundrues;
 - raportim të zonës së parashikuar për gjueti;
 - komunikim për siguri trafiku me mjetet e tjera lundruese në lundrim të lirë dhe në situata kur është në gjueti e sipër;
 - komunikim në rastet e operacioneve SAR të kërkim shpëtimit;
 - anulimi i një alarmi të dhënë fals;
- Hedhja e shënimeve të komunikimit në ditarin e lundrimit;
- Raportimi Kapitenit për konstatimet, funksionimin e paisjeve të radios dhe mesazhe të mara nga përgjuesi automatik i frekuencës së avarisë 2182 kHz;
- Mirëmbajtja dhe përdorimi i radios së dorës të emergjencës, përfshirë gatishmërinë e baterive një përdorimshe;
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale
- Rregullat sigurimit teknik, mbrojtjes së mjedisit dhe mbrojtjes nga zjarri.
- Mirëmbajtja e vendit të punës gjatë përdorimit të pajisjeve të radiokomunikimit detar të zonës A1 të instaluar në anije.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të ndezë radion VHF (very high frequency) të llojit DSC (digital selective call) të instaluar në anije;
- të transmetojë me anë të radios, në frekuencën (kanalin) e përcaktuar si:
 - njoftim kapitenerisë për nisje të mjetit lundrues për gjueti;
 - njoftim kapitenerisë për dalje nga porti të mjetit lundrues;
 - raportim të zonës së parashikuar për gjueti;
 - komunikim për siguri trafiku me mjetet e tjera lundruese në lundrim të lirë dhe në situata kur është në gjueti e sipër;
 - komunikim në rastet e operacioneve SAR të kërkim shpëtimit;
 - anulim të një alarm të dhënë fals;
- të hedhë shënimet e komunikimit në ditarin e lundrimit;

- ti raportoje kapitenit për konstatimet, funksionimin e paisjeve të radios dhe mesazhe të mara nga përgjuesi automatik i frekuencës së avarisë 2182 kHz;
- të mirëmbajë dhe përdorë radiot e dorës të emergjencës përfshirë gatishmërinë e baterive një përdorimshe;
- të raportoje tek Kapitenit për konstatimet dhe gatishmërinë
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, ruajtjes së mjedisit detar, higjenës dhe mbrojtjes nga zjarri;
- të mirëmbajë vendin e punës.

RM 5 Nxënësi kryen manovra për hedhje/marje spirance.

Përmbajtja

Hedhja e spirancës

- Përzgjedhja e vendit për hedhje spirance;
- Vlerësim i thellësisë, gjatësisë së gadinës së spirancave për çdo bord, drejtimin të erërave, rrymave dhe mjeteve lundruese përreth;
- Informimi sektorit të makinerisë dhe kuvertës për hedhje spirance;
- Zvogëlim i shpejtësisë ndërkohë që afrohem në vendin për hedhje spirance;
- Dhënie komande për përgatitje të vinçit të sipirancës për hedhje;
- Vendosje telegrafe në “zero” dhe lëvizje me inerci deri në arritjen e ndalimit të inercisë;
- Përdorimi i motorrit mbrapa nëse nevojitet për ndalim anije;
- Dhënia e komandës për hedhje spirance dhe ndjekja e hedhjes;
- Dhënia e telegrafës mbrapa me ngadalë për pak sekonda dhe më pas stop deri sa gadina të shikojë para e “karikuar”;
- Fiksimi i sigurtë i noflave bllokuese të gadinës së spirancës;
- Vendosja e simboleve të anijes në spirancë dukshëm;
- Komunikimi me sallën e kontrollit të trafikut për emrin, pozicionin, arsyen e kohën e mundshme për qëndrim në spirancë;
- Caktimi i personelit të shërbimit në spirancë;
- Vendosja e rojeve shtesë për kallmim të mundshëm të spirancës në paisjet radionavigacionale si gps, ais, etj.
- Kontrolli periodik i pozicionit të anijes në raport me pozicionin fillestar të hedhjes së spirancës;

Marrja e spirancës

- Informimi sektorit të kuvertës dhe makinerisë për marje spirance;
- Ndezja e motorrit kryesor gati për lëvizje;
- Lirimi i noflave të gadinës së spirancës;
- Dhënia e komandës për marje spirance duke e “ndihmuar” me lëvizje të motorrit në drejtim të kundërt me atë të gadinës;
- Informimi për copat e futura në pusin e gadinës;

- Fiksimi i spirancës dhe gadinës në vinç;
- Fillimi i lëvizjes për lundrim drejt destinacionit të dhënë;
- Heqja e simboleve të qëndrimit në spirancë;
- Komunikimi me sallën e kontrollit të trafikut për emrin dhe faktin emarjes së spirancës dhe lundrimit drejt destinacionit;
- Pastrimi i vendit dhe mjeteve të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së manovrave për hedhje/marrje spirance.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

Për hedhjen e spirancës

- të përzgjedhë me kujdes një vend të sigurtë nga aspektet meteorologjike, rreziqeve nën-ujore dhe trafikut detar për hedhje spirance;
- të interpretojë vlerësimin e bërë lidhur me thellësinë e ujit, gjatësinë e gadinës së spirancave për çdo bord, drejtimit të erërave, rrymave dhe mjeteve lundruese përreth;
- të informojë qartë, me zë të lartë, mjete komunikimi dhe provë telegrafe sektorin të makinerisë dhe të kuvertës për hedhje spirance;
- të lëvizë telegrafën/koplunin për ulje shpejtësie ndërkohë që mjeti lundrim afrohet në vendin për hedhje spirance;
- të japë qartë, me zë të lartë dhe mjete komunikimi komandën për përgatitje të vinçit të sipirancës për hedhje;
- të vendosë telegrafën në “zero” dhe ndjekë me vëmendje lëvizjen me inerci deri në arritjen e ndalimit të inercisë;
- të përdorë telegrafën/koplunin për lëvizje të motorrit mbrapa nëse nevojitet për ndalim anije;
- të japë qartë, me zë të lartë, mjete komunikimi komandën për hedhje spirance dhe ndjekja e hedhjes;
- të lëvizë telegrafën/koplunin mbrapa me ngadalë për pak sekonda dhe më pas stop deri sa gadina të shikojë para e “karikuar”;
- të japë qartë, me zë të lartë, mjete komunikimi komandën për fiksime të sigurtë të noflave bllokuese të gadinës së spirancës;
- të vendosë dukshëm për trafikun detar simbolet e anijes në spirancë;
- të komunikojë sipas rregullave të GMDSS me sallën e kontrollit të trafikut për emrin, pozicionin, arsyen e kohën e mundshme për qëndrim në spirancë të anijes;
- të caktojë dhe informojë me zë dhe shkrim personelin e shërbimit në spirancë;
- të caktojë roje shitesë në pajisjet radionavigacionale si gps, ais, etj., për kallmim të mundshëm të spirancës.
- të kryejë kontrolle periodike të pozicionit të anijes në raport me pozicionin fillestar të hedhjes së spirancës;

Për marrjen e spirancës:

- të informjë qartë, me zë të lartë, mjete komunikimi sektorin e kuvertës dhe makinerisë për marje spirance;
- të japë urdhër qartë, me zë të lartë, mjete komunikimi dhe telegrafë për ndezjen e motorrit kryesor gati për lëvizje;
- të japë urdhër të qartë, me zë të lartë, mjete komunikimi për lirim e noflave të gadinës së spirancës;
- të japë qartë, me zë të lartë, mjete komunikimi komandën për marje spirance duke e “ndihmuar” me lëvizje të motorrit në drejtim të kundërt me atë të gadinës;
- të kërkojë nga personeli që mer spirancën të informohet qartë, me zë të lartë, me mjete komunikimi dhe me gositje çange për copat e futura në pusin e gadinës;
- të japë urdhër të qartë, me zë të lartë, mjete komunikimi për fiksimin e sigurtë të spirancës dhe gadinës në vinç;
- të informojë qartë, me zë të lartë dhe mjete komunikimi fillimin e lëvizjes për lundrim drejt destinacionit të dhënë;
- të heqë simbolet navigacionale të qëndrimit në spirancë;
- të komunikojë sipas rregullave të GMDSS me sallën e kontrollit të trafikut për emrin dhe faktin emarjes së spirancës dhe lundrimit drejt destinacionit;
- të pastrojë vendin dhe mjetet e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 6 Nxënësi kryen manovra për akostim në bankinë.

Përmbajtja

- Informimi sektorit të makinerisë dhe kuvertës për afrim në bankinë;
- Komunikimi me lokalit e makinerisë me zë dhe provë telegrafe për gatishmërinë për fillimin e manovrave;
- Zvogëlimi i shpejtësisë deri në inerci për manovrim të anijes;
- Sigurimi për marjen e masave për sigurinë, shëndetin dhe mbrojtjes së mjedisit;
- Sigurimi që në bankinë ka njerëz profesionistë të njohur për lidhjen e cimave nga kalunët e kalatës;
- Vrojtimi i rrethanave meteorologjike, kryesisht drejtimi dhe forca e erës;
- Vlerësimi të mënyrës së akostimit në raport me efektet e erës, drejtimit të afrimit të anijes, mjeteve të tjera të akostuara, në lundrim apo objekteve përreth;
- Informimi i ekuipazhit në kuvertë për mënyrën e akostimit;
- Dhënia e komandës për përgatitjen e cimave dhe vendosjen e gomave në bordin e parashikuar për akostim;
- Dhënia e komandës ekuipazhit të kuvertës/personave në kalatë për hedhje/kapje të cimave sipas planit të akostimit;
- Dhënia e komandës lokalit të makinerisë me telegrafë për lëvizjen e motorrit për akostim;
- Dhënia komandave për marjen e cimave dhe sigurim sipas planit të akostimit;

- Ndjekja e manovrës në të gjithë aspektet e saj;
- Sigurimi i cimave dhe i agregateve të përdour të kuvertës;
- Dhënia e komandës për mbarim manovre lokalit të makinerisë;
- Raportimi Sallës së Kontrollit të Trafikut Detar për lidhjen e sigurtë në bankinë;
- Kryerja e veprimeve për dorëzimin e produkteve të zëna nga gjuetia në frigoriferin e stabilimentit mbledhës;
- Informimi ekuipazhit për orarin e shërbim/pushimit gjatë qëndrimit bankinë;
- Raportimi Kapitenit për konstatimet dhe kryerjen e detyrave;
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale;
- Pastrimi i vendit dhe mjeteve të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të informojë qartë, me zë të lartë dhe mjete komunikimi sektorin e kuvertës për afrim në bankinë;
- të komunikojë qartë me lokalit e makinerisë me zë dhe provë telegrafe për gatishmërinë për fillimin e manovrave;
- të lëvizë telegrafën/koplunin pr ulje shpejtësie deri në inerci për manovrim të anijes;
- të sigurohet për marjen e masave për sigurinë, shëndetin dhe mbrojtjes së mjedisit;
- të sigurohet që në bankinë ka njerëz profesionistë të njohur për lidhjen e cimave nga kalunët e kalatës;
- të interpretojë rrethanat meteorologjike, kryesisht drejtimi dhe forca e erës nga vrojtimi;
- të interpretojë mënyrën e parashikuar të akostimit në raport me efektet e erës, drejtimin të afrimit të anijes, mjeteve të tjera të akostuara, në lundrim apo objekteve përreth;
- të informojë qartë, me zë të lartë dhe mjete komunikimi ekuipazhin në kuvertë për mënyrën e akostimit;
- të japë qartë, me zë të lartë dhe mjete komunikimi komandën për përgatitjen e cimave dhe vendosjen e gomave në bordin e parashikuar për akostim;
- të japë qartë, me zë të lartë dhe mjete komunikimi komandën ekuipazhit të kuvertës/personave në kalatë për hedhje/kapje të cimave sipas planit të akostimit;
- të japë qartë, me zë të lartë, mjete komunikimi dhe telegrafë komandën lokalit të makinerisë për lëvizjen e motorrit për akostim;
- të japë qartë, me zë të lartë dhe mjete komunikimi komanda për marjen e cimave dhe sigurim sipas planit të akostimit;
- të ndjekë manovrën në të gjithë aspektet e saj, në zbatim komande në kuvertë, në makineri, kontakte me mjete/objekte përreth, lëvizje të mjetit lundrues dhe efekteve të erës/detit mbi të;

- të sigurohet për lidhjen e sigurtë të cimave dhe agregateve të përdorur të kuvertës;
- të jape saktë, me zë të lartë dhe mjete komunikimi komandën për mbarim manovre lokalit të makinerisë;
- të raportojë tel Salla e Kontrollit të Trafikut Detar për lidhjen e sigurtë në bankinë sipas rregullave të GMDSS;
- të kryejë me rend dhe siguri veprimet për dorëzimin e produkteve të zëna nga gjuetia në frigoriferin e stabilimentit mbledhës;
- të informojë qartë dhe me shkrim ekuipazhit për orarin e shërbim/pushimit gjatë qëndrimit bankinë;
- të raportojë tek Kapiteni për konstatimet dhe kryerjen e detyrave;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale;
- të pastrojë vendin dhe mjetet e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit kryerjes së manovrave për akostim në bankinë.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në anije në lundrim.
- Kapiteni duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrimet dhe demonstrimet konkrete të praktikave të aplikueshme të komunikimit detar, përdorimit të pajisjeve radionavigacionale të instaluar në anije për një lundrim të sigurtë dhe efikas të anijes.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete, në mbështetje të përvetësimit të njohurive që trajton moduli.
- Gjithashtu ata duhet të angazhohen në përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve që përdoren në proceset dhe detyrat para, gjatë dhe në mbërritje nga lundrimi, përfshirë akostim/ç'akostimin, hedhje/marje spirance si dhe manovra të tjera sipas rrethanave lundrimore, korigjimin e busullës magnetike, matje këndesh me sekstant, etj.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Anije e pajisur me të gjitha mjetet dhe pajisjet e duhura të radionavigacionit të instaluar në anije për të realizuar një lundrim të sigurtë dhe efikas.
 - Pankarta, makete, udhëzues, katalogë, rregullore, standarte, manuale teknike etj.
 - Materiale të shkruara në mbështetje të trajtimit të modulit.
-

2. Moduli “Aftësimi në mjetet e mbijetesës dhe të shpëtimit, përjashtuar mjetet e shpejta të shpëtimit - IMO 1.23”

Drejtimi: Detari
Niveli: III
Klasa: 13

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kod	AFTËSIMI NË MJETET E MBIJETESËS DHE TË SHPËTIMIT, PËRJASHTUAR MJETET E SHPEJTA TË SHPËTIMIT (IMO 1.23)	M-30-1411-18
Qëllimi i modulit	Një modul teorik e praktik që i pajis nxënësit me aftësi për të ndërmarrë veprime sipas standardit minimal të kompetencës në mjetin e mbijetesës dhe barkat e shpëtimit, <i>përjashtuar barkat e shpejta të shpëtimit</i> , në operimin e tyre gjatë dhe mbas uljes në ujë, në operimin e motorrit, në menaxhimin e mjetit dhe të mbijetuarve mbas braktisjes së anijes, në operimin korrekt të të gjithë paisjeve lokalizuese, përfshirë paisjet e komunikimit, të sinjalizimit dhe mjetet piroteknike, në aplikimin e dhënies së ndihmës së pare për të mbijetuarit përfshirë veprime për ruajtjen e jetës së personave nën komandë.	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kl.12 në një nga profilet e niv.II të drejtimit mësimor “Detari”. Ata duhet të jenë të aftë nga ana shëndetsore sipas kërkesave të Rregullit 1/9 të STCW ’78, i amenduar.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi komandon mjetin e mbijetesës apo të shpëtimit gjatë dhe mbas lëshimit në ujë.</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëzimet mbi sigurinë dhe ekspozimi i tyre; - Rëndësia e zbatimit të rregullave të sigurisë; - Dhënia e urdhërit për veshjen e xhakave të shpëtimit; - Dhënia e urdhërit për hipjen e personave në mjetin e mbijetesës para uljes në ujë; - Dhënia e urdhërit për uljen e mjetit të mbijetesës në ujë me personat në bord; - Udhëzimi për ruajtjen e mjetit të mbijetesës me trupin e anijes deri në ulje; - Dhënia e urdhërit për heqjen e ganxhave të mekanizmit të uljes së mjetit të mbijetesës; - Dhënia e urdhërit për ndezjen e motorrit të mjetit të mbijetesës dhe largimin nga anija; - Dhënia e urdhërit për hedhjen në ujë të pjesës tjetër të grupit nga anija; - Dhënia e urdhërit për hipjen në mjetin e mbijetesës mbas hedhjes në ujë; - Dhënia e urdhërit për veshjen e kostumit të zhytjes dhe 	

- veshjeve të mbrojtjes termike mbas hipjes në mjetin e mbijetesës;
- Dhënia e urdhërit për lëvizje dhe manovra të mjetit të mbijetesës për mbledhjen dhe hipjen në mjet të të mbijetuarve të tjerë në ujë;
 - Dhënia e urdhërit për lëvizje dhe manovra të mjetit të mbijetesës për mbledhjen e mjeteve të tjera të mbijetesës për qëndrim në grup;
 - Kryerja e komandimit/urdhërimit në kushtet e detit të trazuar;
 - Dhënia e urdhërit për lëvizje dhe manovra të mjeteve të mbijetesës në grup për largim në drejtimin e duhur nga anija;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Pyetje përgjigje me shkrim
- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të japë udhëzime mbi sigurinë dhe ekspozimin e tyre;
- të urdhërojë veshjen e xhaketave të shpëtimit për grupin;
- të urdhërojë hipjen e dy personave në mjetin e mbijetesës para uljes në ujë;
- të urdhërojë uljen e mjetit të mbijetesës në ujë me dy persona në bord;
- të udhëzojë personat në mjetin e mbijetesës t'a ruajnë nga përplasjet me trupin e anijes deri në ulje;
- të urdhërojë dy personat në mjetin e mbijetesës të heqin ganxhat e mekanizmit të uljes së mjetit të mbijetesës;
- të urdhërojë ndezjen e motorrit të mjetit të mbijetesës dhe largimin nga anija;
- të urdhërojë hedhjen në ujë nga anija të pjesës tjetër të grupit;
- të urdhërojë hipjen në mjetin e mbijetesës nga grupi mbas hedhjes në ujë;
- të urdhërojë veshjen e kostumit të zhytjes dhe veshjeve të mbrojtjes termike nga grupi mbas hipjes në mjetin e mbijetesës;
- të urdhërojë lëvizje dhe manovra të mjetit të mbijetesës për mbledhjen dhe hipjen në mjet të të mbijetuarve të tjerë në ujë
- të urdhërojë lëvizje dhe manovra të mjetit të mbijetesës për mbledhjen e mjeteve të tjera të mbijetesës për qëndrim në grup;
- të kryejë komandimet/urdhërimet në kushtet e detit të trazuar;
- të urdhërojë lëvizje dhe manovra të mjeteve të mbijetesës në grup për largim në drejtimin e duhur nga anija;

RM 2 Nxënësi operon motorrin e mjetit të mbijetesës.

Përmbajtja:

Ndezja e motorrit të mjetit të mbijetesës:

- Kryerja e kontrolleve për karburant, vaj lubrifikant, etj.
- Ndjekja e udhëzimeve të prodhuesit dhe vendos në pozicion çelësat/levat e duhura;
- Kryerja e ndezjes së motorrit dhe vendos rregullatorin në pozicionin e punës;
- Kryerja e kontrolleve të presioneve vajit, ujit të ftohjes, nqs ka;
- Kryerja e lëvizjeve para, mbrapa dhe manovra afrimi dhe largimi nga anija;
- Fikja e motorrit të mjetit të mbijetesës;
- Kryerja e pastrim/zëvendësim filtrash të ajrit dhe naftës;
- Kryerja e karikimit të baterive nga anija dhe motorri;
- Interpretimi në vend funksionin e sistemeve dhe paisjeve në mjetin e mbijetesës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Pyetje përgjigje me shkrim
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

Ndezja e motorrit të mjetit të mbijetesës:

- të kryejë kontrollin për karburant, vaj lubrifikant, etj.
- të ndjekë udhëzimet e prodhuesit dhe vendosë në pozicion çelësat/levat e duhura;
- të kryejë ndezjen e motorrit dhe vendosë rregullatorin në pozicionin e punës;
- të kryejë kontrollin e presionit të vajit, ujit të ftohjes, nqs ka;
- të kryejë lëvizje para, mbrapa dhe manovra afrimi dhe largimi nga anija për jo më pak se 5 minuta në ujë;
- të fikë motorrin e mjetit të mbijetesës;
- të kryejë pastrim/zëvendësim filtrash të ajrit dhe naftës;
- të kryejë karikimin e baterive dhe nga anija dhe motorri;
- të interpretojë në vend funksionin e sistemeve dhe paisjeve në mjetin e mbijetesës si: fikset e zjarrit me bobola apo me ujë, sistemin e cekimit të ujit nga mjeti i mbijetesës, sistemet e ajrimit, etj.

RM 3 Nxënësi komandon mjetin e mbijetesës dhe të mbijetuarit mbas braktisjes së anijes

Përmbajtja:

Veprimet pas largimit me mjetin e mbijetesës:

- Dhënia e ndihmës së pare.
 - Pozicionimi i njerëzve dhe i pajisjeve në mjet.
 - Dhënia e detyravet gjithë secilin.
 - Përdorimi i tabletave kundra zënies së detit.
 - Lidhja e mjeteve të mbijetesës me njëra tjetrën me cimë.
 - Përgatitja e EPIRB-it.
-

-
- Udhëzime të tjera për mbijetesën;
 - Dhënia e urdhërit timonierit për kurset dhe grupin për ruajtjen e rregullit dhe kryerjen e detyrave për mbijetesën.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Pyetje përgjigje me shkrim

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

Veprimet pas largimit me mjetin e mbijetesës:

- të kryejë dhënien e ndihmës së parë,
- të pozicionojë njerëzit dhe paisjet në mjet për të ruajtur stabilitetin dhe lundrueshmërinë e mjetit,
- të japë detyrat për gjithë secilin,
- të përdorë tabletat kundra zënies së detit,
- të lidhë mjetet e mbijetesës me njëra tjetrën me cimë,
- të përgatitë EPIRB-in,
- të japë udhëzime të tjera për mbijetesën, si mbajtja e moralit, ruajtja e vëzhgimit të pandërprerë, rreziqet potenciale, racionimi dhe efektet nga konsumi i ushqimit dhe ujit, shfrytëzimi i shiut për ujë dhe detit për ushqim, dehidratimin, veprimet në rastin e shpëtimit me asistencë helikopteri, etj.;
- të urdhërojë timonierin për kurset dhe grupin për ruajtjen e rregullit dhe kryerjen e detyrave për mbijetesën.

RM 4 Nxënësi përdor pajisjet lokalizuese, të komunikimit, të sinjalizimit dhe mjetet piroteknike në mjetin e mbijetesës

Përmbajtja:

Përdorimi i sinjaleve, paisjeve sinjalizuese dhe mjeteve piroteknike:

- Përdorimi i sinjaleve të ndryshme të rrezikut;
- Përdorimi i pajisjes së sinjalizimit;
- Përdorimi i mjeteve piroteknike;
- Përdorimi i elektrikut të dore;
- Përdorimi i pasqyrës ditore;
- Përdorimi i bilbilit;
- Hapja dhe sigurimi i velave të mjetit të mbijetesës;
- Përdorimi i projektorit të kërkim-shpëtimit;

Përdorimi i paisjeve të lokalizimit dhe komunikimit:

- Përdorimi i radios së mjetit të mbijetesës;
- Përdorimi i EPIRB-it për të transmetuar sinjalet e rrezikut sistemit satelitor;
- Përdorimi i SART-it për transmetim sinjalirreziku i mjeteve lundruese në zonën e fatkeqsisë;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Pyetje përgjigje me shkrim
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

Përdorimi i sinjaleve, paisjeve sinjalizuese dhe mjeteve piroteknike:

- të përdorë sinjalet e ndryshme të rrezikut;
- të përdorë paisjen e sinjalizimit;
- të përdorë mjete piroteknike, parashutë, zjarr dore dhe tymueset;
- të përdorë elektrik dore për sinjalizim me kodin mors;
- të përdorë pasqyrën ditore për sinjalizim;
- të përdorë bilbilin;
- të hapë dhe sigurojë velat e mjetit të mbijetesës;
- të përdorë projektorin e kërkim-shpëtimit;

Përdorimi i paisjeve të lokalizimit dhe komunikimit:

- të përdorë radion e mjetit të mbijetesës;
- të përdorë EPIRB-in për të transmetuar sinjalet e rrezikut sistemit satelitor;
- të përdorë SART-in për transmetim sinjalirreziku mjeteve lundruese në zonën e fatkeqsisë;

RM 5 Nxënësi jep ndihmën e parë të mbijetuarve në mjetin e mbijetesës në ujë.

Përmbajtja:

- Teknikat e rigjallërimit në kushtet e mjetit të mbijetesës;
- Teknikat për shtypje të kraharorit për rastet e arrestit kardiak;
- Teknikat e frymëdhënies gojë-më-gojë;
- Teknikat e pozicionimit të të mbijetuarit me probleme të pa-vetëdijes;
- Veprimet e dhënies së ndihmës së parë në raste gjakosje, frakturash, djegiesh, shoku, kontaminimit nga karburanti, zënies së morthit, goditjes nga moti i nxehtë, ftohjes së këmbëve, etj.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Pyetje përgjigje me shkrim
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përdorë teknikat e rigjallërimit në kushtet e mjetit të mbijetesës;
 - të përdorë teknikat për shtypje të kraharorit për rastet e arrestit kardiak;
 - të përdorë teknikat e frymëdhënies gojë-më-gojë;
 - të përdorë teknikat e pozicionimit të të mbijetuarit me probleme të pa-vetëdijes;
 - të kryejë veprimet e dhënies së ndihmës së parë në raste gjakosje, frakturash, djegiesh, shoku, kontaminimit nga karburanti, zënies së morthit, goditjes nga moti i nxehtë, ftohjes së këmbëve, etj.
-

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë, në anije dhe në pishinë.
- Aspektet teorike duhet të trajtohen të lidhura ngushtë me procedurat praktike përkatëse.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të proceseve të përdorimit të mjeteve individuale dhe kolektive të emergjencës në anije
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve për përdorimin e mjeteve vetjake dhe kolektive të mbijetesës.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, në përdorimin e mjeteve vetjake dhe kolektive të mbijetesës.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin e pjesës teorike të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:

Klasë, mjedis anijeje, pishinë.

Tavolinë për demonstrime me përmasa 3 m me 1 m.

Materiale audio-vizive apo materiale të shkruara për aspektet teorike si:

- Një mjet lundrimi mbijetese të mbyllur me plastikë vetro-rezine afro 8 metra gjatësi, e paisur me motor të brendshëm naftë, i paisur plotësisht me të gjithë elementët e një mjeti mbijetese dhe që mund të përdoret edhe për vozitje me rrema. (mjetet e reja apo ato të revizionuara duhet të jenë edhe me veshje zjarrduruese që përmbushin kërkesat e Seksionit 6.1 të Kodit të Mjeteve Jetë-Shpëtuese (LSA Code)) me një komplet strukture të vendosjes së mjetit të mbijetesës në atë mënyrë që të mund lëshohet në ujë.
 - Një mjet shpëtimi plastike vetro-rezine me motor të jashtëm me kompletin e strukturës për vendosje dhe lëshim në ujë të mjetit të shpëtimit;
 - Dy trape pneumatike me fryrje në kontenitorët e tyre, njëri prej të cilëve i vendosur në bazamentin ku mund të aktivizohet vetë-pluskimi nëpërmjet paisjes të lëshimit hidrostatik;
 - Një komplet të pajimeve të trapit pneumatik
 - Xhaketa shpëtimi mjaftueshëm për të gjithë nxënësit, instruktorët e të tjerë në mjetin e mbijetesës,
 - Kostume zhytje dhe kostume mbrotëse termike anti-ekspozim
 - Një radio dore e modelit të miratuar për përdorim komunikimi në një mjet mbijetese;
 - Një komplet demonstrimi mjeteve piroteknike mjeti mbijetese;
 - 1 EPIRB Sinjalizues Radiofonik që Tregon Vend-ndodhjen e Avarisë (i ç'aktivizuar) që punon me frekuencë 460 MHz për demonstrime
 - Një transponder kërkim-shpëtimi (SART) që punon me frekuencë 9 GHz për demonstrime;
 - Një slingë kapje që përdoret në raste shpëtimi me helikopter;
 - Një manikin për trajnime të ri-gjallërimit;
 - Një barrelë e tipit *Neil Robertson* për përdorim në ushtrime;
-

3. Shërbime mirëmbajtëse elektromekanike në anije

Drejtimi: Detari

Niveli: III

Klasa: 13

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	SHËRBIME MIRËMBAJTËSE ELEKTROMEKANIKE NË ANIJE	M-30-1412-18
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson nxënësit për të realizuar shërbime mirëmbajtëse dhe riparuese të thjeshta, të orientuara dhe kufizuara në agregatet dhe pajisjet elektromekanike në sektorin e kuvertës dhe sektorin e makinerisë së mjetit të lundrimit.	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kl.12 në një nga profilet e niv.II të drejtimit mësimor “Detari”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi kryen mirëmbajtje/riparime të thjeshta në makinerinë kryesore dhe ndihmëse të mjetit lundrues. <i>Përmbajtja</i> <ul style="list-style-type: none">- Identifikimi i dokumentacionit teknik përkatës.- Analiza e skemës së agregatit për mirëmbajtje.- Vlerësim dhe përcaktim i punimeve për t’u kryer dhe vendit.- Marja e masave për sigurinë, shëndetin, kundra zjarrit dhe mjedisin përfshirë veshjet personale.- Rrethimi i vendit të punimeve.- Krijimi i rrugëkalimeve hyrje-dalje dhe përreth punimeve.- Përgatitje e veglave dhe instrumentave për punë.- Marja e lejes për punime.- Informimi i personelit që ndikohet nga punimet. <u>Mirëmbajtje testate:</u> <ul style="list-style-type: none">- Zmontimi i testatës;- Zmerilimi i valvolave;- Përgatitje për montim i guarnicionit të testatës;- Montim i testatës komplet; <u>Ndërrim pistoni:</u> <ul style="list-style-type: none">- Zmontimi i bijelës;- Heqja e pistonit së bashku me bjelën jashtë;- Zmontimi i spinotit të pistonit;- Matje tolerance të këmishës;- Montimi i bjelës bashkë me spinotin tek pistoni;- Vendosje pistoni me fashat e reja në këmishë;- Montimi i bijelës në qafën e saj;- Montimi i testatës bashkë me guarnicionet;	

-
- Kryerja e provave;

Mirëmbajtje të valvolave të ujit:

- Identifikimi i valvolës së dëmtuar/difektuar;
- Gjetja një valvole të re të njejtë me valvolën e dëmtuar;
- Mbyllja e saraçiskës përkatëse;
- Zmontimi i valvolës së dëmtuar/difektuar;
- Montimi i valvolës së re me guarnicionet;
- Hapja e saraçineskës për punë

Ndërrimi i filtrave të vajit, naftës, ajrit:

- Gjetja e filtrave të reja për zëvendësim;
- Mbyllja e saraçineskës përkatëse;
- Zmontim i filtrave ekzistues;
- Montim i filtrave të reja;
- Hapja e saraçineskës për punë;
- Kryerja e provave pa ngarkesë të motorrit pas punimeve mirëmbajtëse;
- Kontrolli i parametrave të ftohjes, presionit, gazrave, vajit, ajrit, etj;
- Prova me ngarkesë së motorrit;

Mirëmbajtje saraçiske të sistemit të ujit të detit:

- Mbyllja e sistemit të ujit që komunikon me agregatin;
- Zmontimi i saraçiskës nga vendi i montuar;
- Zomntimi në pjesë i saraçineskës vetë;
- Pastrimi dhe kepja nga pa-pastërtitë dhe ndryshku;
- Lyerja me bojë i saraçineskës;
- Zmerilimi i “këpurdhës” në folenë e saj;
- Prova për hermetizim me pastë;
- Prova hidraulike duke e lidhur me pompën e presimit;
- Montimi i saj në vend;
- Hapja e sistemeve të ujit;

Të përgjithshme:

- Kryerja e shënimeve në ditar;
- Informimi për përfundimin dhe rezultatet e punimeve;
- Lirimi i pengesave rrethuese pas përfundimit të punimeve;
- Pastrimi dhe vendosja në vendim e përcaktuar të veglave dhe instrumentave;
- Komunikimi me profesionalizëm dhe etikë profesionale.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik, mbrojtjes së mjedisit, mbrojtjes nga zjarri dhe pastrimit të vendit të punës në përfundim të saj.

Instrumentat e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të identifikojë dokumentacionin teknik përkatës;
- të analizojë dokumentacionin teknik të agregatit për mirëmbajtje.
- të vlerësojë dhe përcaktojë punimet për t’u kryer dhe vendit;
- të marrë masat për sigurinë, shëndetin, kundra zjarrit dhe

-
- mjedisin përfshirë veshjet personale;
- të rrethojë vendin e punimeve për të mos-lejuar hyrjen e të pa-punëve;
 - të krijojë rrugëkalimet e hyrje-daljes dhe përreth punimeve për mbikqyrje punimesh;
 - të përgatisë veglat dhe instrumentat përkatës për punë;
 - të plotësojë një formular për marjen e lejes për punime;
 - të informojë qartë dhe të afishojë me shkrim personelin që ndikohet nga punimet dhe në hyrje të sektorit;

Për mirëmbajtjen e testateve:

- të realizojë zmontimin me rend dhe kujdes të testatës;
- të zmerilojë mirë valvolat;
- të përgatisë për montim guarnicionin e testatës;
- të realizojë montimin me rend dhe kujdes të testatës komplet;

Për ndërrimin e pistonit:

- të realizojë zmontimin me kujdes dhe rend të bijelës;
- të heqë me rend dhe kujdes pistonin me bjelën jashtë;
- të zmontojë me kujdes spinotin e pistonit;
- të masë saktë tolerancën e këmishës;
- të montojë me kujdes dhe rend bjelën bashkë me spinotin tek pistonit;
- të vendosë me kujdes dhe rend pistonin me fashat e reja në këmishë;
- të realizojë montimin me kujdes dhe rend të bijelës në qafën e saj;
- të realizojë montimin me kujdes dhe rend të testatës bashkë me guarnicionet;
- të kryerë provat përkatëse;

Për mirëmbajtjen e valvolave të ujit:

- të identifikojë valvolën e dëmtuar/difektuar;
- të gjejë një valvole të re të njejtë me valvolën e dëmtuar;
- të realizojë mbylljen mirë të saraçiskës përkatëse;
- të zmontojë me kujdes dhe rend valvolën e dëmtuar/difektuar;
- të montojë me kujdes dhe rend valvolën e re me guarnicionet;
- të hapë saraçineskën për punë;

Për ndërrimin e filtrave të vajit, naftës, ajrit:

- të gjejë filtrat e reja për zëvendësim;
- të mbyllë mirë saraçineskën përkatëse;
- të zmontojë me kujdes dhe rend filtrat ekzistues;
- të montojë me kujdes dhe rend filtrat e reja;
- të hapë saraçineskën për punë;
- të kryejë prova pa ngarkesë të motorrit pas punimeve mirëmbajtëse;
- të kontrollojë parametrat e ftohjes, presionit, gazrave, vajit, ajrit, etj;
- të kryejë prova me ngarkesë së motorrit;

Për mirëmbajtjen saraçiske të sistemit të ujit të detit:

- të mbyllë mirë sistemin e ujit që komunikon me agregatin;
- të zmontojë me kujdes saraçineskën nga vendi i montuar;
- të realizojë zomntimin në pjesë i saraçineskës vetë;
- të pastrojë dhe kepë saraçineskën dhe pjesët nga papastërtitë dhe ndryshku;
- të lyejë me bojën përkatëse saraçineskën;
- të zmerilojë “këpurdhën” në folenë e saj;
- të kryejë prova për hermetizim me pastë;
- të kryejë provën hidraulike duke e lidhur me pompën e presimit;
- të montojë me rend saraçineskën në vend;
- të hapë sistemet e ujit;

Të përgjithshme:

- të bëjë shënimet për rezultatet e punimeve të kyrera qartë dhe saktë në ditar;
- të informojë qartë dhe me zë për përfundimin dhe rezultatet e punimeve;
- të largojë pengesat rrethuese pas përfundimit të punimeve;
- të pastrojë dhe vendosë në vendin e përcaktuar të veglave dhe instrumentave të përdorura në punime;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, mbrojtjes së mjedisit, mbrojtjes nga zjarri dhe pastrimit të vendit të punës në përfundim të saj.
- të mirëmbajë vendin e punës.

RM 2 Nxënësi kontrollon punën e agregateve dhe sistemeve për difekte dhe merr masat paraprake

Përmbajtja

Sistemi i drejtimit:

- Analiza e skemës teknike të sistemit të drejtimit;
- Kryerja e kontrollit vizual të përgjithshëm të sistemit nga ura e komandës deri në lokalin e timonit;
- Vënia në punë e sistemit;
- Kontrolli i presionit të vajit nga prova me lëvizje timoni nga njëri bord në tjetrin;
- Kontrolli për rrjedhje vaji gjatë gjithë sistemit nga ura e komandës deri në lokalin e timonit;
- Kontrolli i punës së telemotorrëve të transmetimit dhe marjes;
- Heqja e ajrit të telemotorrëve;
- Kalimi nga sistemi elektro-hidraulik në atë mekanik;
- Krahasimi i pozicionit të pallës së timonit në raport me treguesit si në timoneri ashtu edhe në lokalin e timonit;
- Prova e komunikimit me timonerinë nga lokali i timonit;

Sistemi Zjarrfikës:

- Vendosje e një shllange zjarrfikëse në saraçineskën e saj;
- Hapje e saraçineskës për punë;
- Ndezja e pompës zjarrfikëse;
- Kontroll i presionit të punës së pompës;

- Kontroll i përgjithshëm i sistemit të tubacioneve për rrjedhje të mundshme;
- Raportim i gjetjeve;
- Ndërhyrje mirëmbajtëse në rast konstatimi rrjedhjesh;

Vinçi tratës së gjuetisë:

- Analiza e skemës teknike të sistemit hidraulik;
- Kontrolli i përgjithshëm visual i vinçit të tratës;
- Vënia në punë e pompës hidraulike;
- Kontrolli i presionit të vajit të punës së pompës;
- Kontrolli i linjës së sistemit të tubacioneve për rrjedhje;
- Vënia në punë e vinçit respektivisht nga xhirot më të ulta deri atom ë të larta, në pozicionet para, stop dhe mbrapa, stop;
- Kontrolli i linjës së sistemit të tubacioneve për rrjedhje;
- Ndërhyrje mirëmbajtëse në rast konstatimi difektesh ose rrjedhjesh;

Kaldaja e ngrohjes:

- Analiza e skemës teknike të sistemit;
- Kontrolli i përgjithshëm vizual i kaldajës në lokalin e makinerisë;
- Kontrolli i sistemit të tubacioneve të transmetimit dhe kaloriferëve të ngrohjes në hotel;
- Hapja e valvolës së kaloriferëve;
- Vënia në punë e pompës së ujit dhe kontroll presioni;
- Ndezja e kaldajës;
- Kontroll i punës së termostatit;
- Nxjerja e ajrit të mundshëm në kaloriferët e hotelit;
- Kontroll i transmetimit të nxehtësisë nëpërmjet verifikimit në çdo kalorifer dhe në indikatorin e kaldajës;
- Ndërhyrje mirëmbajtëse në rast konstatimi rrjedhjesh;

Sistemi ftohjes së dhomës frigoriferike:

- Analiza e skemës teknike të sistemit;
- Kontrolli i përgjithshëm vizual i kompresorëve në lokalin e tyre;
- Kontroll i dhomës frigoriferike nga brenda, të ndriçimit dhe i dyerve për hermetizim;
- Prova e ziles së alarmit në rast bllokimi të njeriut në dhomën frigoriferike;
- Kontrolli i manometrave dhe termometrave të kompresorëve dhe dhomës frigoriferike;
- Vënia në punë e kompresorëve dhe kontroll i presionit;
- Kontrolli i ftohjes së dhomës frigoriferike nga termometrat;
- Kontroll për rrjedhje të tubacioneve;
- Ndërhyrje mirëmbajtëse në raste rrjedhjesh;

Të përgjithshme:

- Raportimi i gjetjeve nga kontrollet;
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etike profesionale;
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit;
- Pastrimi i vendit të punës

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

Për sistemin e drejtimit:

- të analizojë me kujdes skemën teknike të sistemit të drejtimit;
- të kryejë me kujdes kontrollin vizual të përgjithshëm të sistemit nga ura e komandës deri në lokalin e timonit;
- të vejë në punë sistemin sipas instruksionit;
- të kontrollojë me kujdes presionin e vajit nga prova me lëvizje timoni nga njëri bord në tjetrin;
- të kontrollojë me kujdes për rrjedhje vaji gjatë gjithë sistemit nga ura e komandës deri në lokalin e timonit;
- të kontrollojë me kujdes punën e telemotorrëve të transmetimit dhe marjes;
- të heqë me kujdes sipas instruksionit ajrin e telemotorrëve;
- të kalojë sipas instruksionit nga sistemi elektro-hidraulik në atë mekanik;
- të bëjë krahasime verifikuese të pozicionit të pallës së timonit në raport me treguesit si në timoneri ashtu edhe në lokalin e timonit;
- të provojë komunikimin e rregullt me timonerinë nga lokali i timonit;

Për sistemin Zjarrfikës:

- të vendosë me kujdes një shllange zjarrfikëse në saraçineskën e saj;
- të hapë me kujdes saraçineskën për punë;
- të ndezë sipas instruksionit pompën zjarrfikëse;
- të kontrollojë me kujdes presionin e punës së pompës;
- të realizojë një kontroll të kujdesshëm të përgjithshëm të sistemit të tubacioneve për rrjedhje të mundshme;
- të raportojë tek Kapiteni gjetjet;
- të bëjë ndërhyrje mirëmbajtëse në rast konstatimi rrjedhjesh;

Për vinçin tratës së gjuetisë:

- të analizojë me kujdes skemën teknike të sistemit hidraulik;
- të realizojë një kontroll të kujdesshëm të përgjithshëm vizual të vinçit të tratës;
- të vejë në punë sipas instruksionit pompën hidraulike;
- të kontrollojë me kujdes presionin e vajit të punës së pompës;
- të kontrollojë me kujdes linjën e sistemit të tubacioneve për rrjedhje;
- të vejë në punë sipas instruksionit vinçin respektivisht nga xhirot më të ulta deri ato më të larta, në pozicionet para, stop dhe mbrapa, stop;
- të realizojë kontroll të kujdesshëm të linjës së sistemit të tubacioneve për rrjedhje;
- të realizojë ndërhyrje mirëmbajtëse në rast konstatimi difektsh ose rrjedhjesh;

Për kaldajën e ngrohjes:

- të analizojë me kujdes skemën teknike të sistemit;
- të realizojë një kontroll të kujdesshëm të përgjithshëm vizual i kaldajës në lokalin e makinerisë për mangësi;
- të kontrollojë me kujdes sistemin e tubacioneve të transmetimit dhe kaloriferëve të ngrohjes në hotel;
- të hapë me rend valvolat e kaloriferëve;
- të vejë në punë sipas instrukcionit pompën e ujit dhe kontrollojë me kujdes presionin;
- të realizojë ndezjen e kaldajës sipas instrukcionit;
- të kontrollojë me kujdes punën e termostatit;
- të nxjerë ajrin e mundshëm në kaloriferët e hotelit;
- të kontrollojë me kujdes transmetimin e nxehtësisë nëpërmjet verifikimit në çdo kalorifer dhe në indikatorin e kaldajës;
- të realizojë ndërhyrje mirëmbajtëse në rast konstatimi difektesh ose rrjedhjesh;

Për sistemin e ftohjes së dhomës frigoriferike:

- të analizojë me kujdes skemën teknike të sistemit;
- të realizojë një kontroll të përgjithshëm vizual të kompresorëve në lokalin e tyre;
- të kontrollojë me kujdes dhomën frigoriferike nga brenda, për ndriçim dhe hermetizim të dyerve;
- të bëjë provën e ziles së alarmit në rast bllokimi të njeriut në dhomën frigoriferike;
- të kontrollojë me kujdes manometrat dhe termometrat e kompresorëve dhe të dhomës frigoriferike;
- të vejë në punë sipas instrukcionit kompresorët dhe kontrollojë me kujdes presionin;
- të kontrollojë ftohjen e dhomës frigoriferike nga termometrat;
- të realizojë kontrole për rrjedhje të tubacioneve;
- të raportojë tek Kapitëni gjetjet;
- të bëjë ndërhyrje mirëmbajtëse në rast konstatimi rrjedhjesh;

Të përgjithshme:

- të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë profesionale;
- të raportojë i gjetjeve nga kontrollet;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- të pastrojë vendin e punës.

RM 3 Nxënësi kryen saldime të thjeshta në lamiera dhe tubacione
Përmbajtja

- Identifikimi i dokumentacionit teknik përkatës.
- Analiza e skemës së agregatit për mirëmbajtje;
- Vlerësim dhe përcaktim i punimeve për t'u kryer dhe vendit;
- Marja e masave për sigurinë, shëndetin, kundra zjarrit dhe mjedisin përfshirë veshjet personale;
- Rrethimi vendit të punimeve;

- Krijimi i rrugëkalimeve hyrje-dalje dhe përreth punimeve;
- Përgatitje e veglave dhe instrumentave për punë;
- Marja e lejes për punime;
- Informimi i personelit që ndikohet nga punimet;

Saldime në lamiera:

- Bërja e shënimeve për të shtrirjes së zonës së dëmtuar për zëvendësim;
- Prerja e lamierës së dëmtuar sipas shënimit;
- Prerja e lamierës së re sipas përmasave të zonës së dëmtuar;
- Zmusimi i buzëve të lamierës së re;
- Prezantimi në vend i lamierës së re;
- Pikimi me saldime në pikat mbajtëse;
- Kryerja e tegelit të saldimit në të gjithë perimetrin e saj;
- Pastrimi i skorjeve mbas saldimit me çekiç dhe furçe teli;
- Zmerilimi dhe lyerja me bojë e lamierës mbas ftohjes;

Saldime në tubacione:

- Mbyllja e saraçineskave komunikuese me sistemin e tubacionit të dëmtuar;
- Zmontim i dy flanxhave që përfshin zonën e tubacionit të dëmtuar;
- Përgatitja e bazamentit prej hekuri me dy flanxha të tjera të ngjashme;
- Prezantimi i tubacionit të dëmtuar brenda flanxhave të bazamentit;
- Fiksimi i flaxhave të bazamentit me flaxhat e tubacionit të dëmtuar;
- Prerja e zonës së dëmtuar/ndryshkur të tubacionit;
- Përgatitja e tubacionit të ri dhe zmusimi i buzëve;
- Prezantimi në vend i tubacionit të ri;
- Pikimi dhe mbushja me saldime përreth në të dy pozicionet;
- Pastrimi i skorjeve të saldimit;
- Lyerja me bojë mbas ftohjes;
- Zmontimi nga bazamenti me flaxhat ku u përgatit tubacioni;
- Përgatitja e guarnicionit për montimin e flanxhave;
- Montimi i pjesës së riparuar në vendin vet;
- Hapja e saraçineskave dhe prova për rrjedhje;

Të përgjithshme:

- Kryerja e shënimeve në ditar;
- Informimi për përfundimin dhe rezultatet e punimeve;
- Lirimi i pengesave rrethuese pas përfundimit të punimeve;
- Pastrimi dhe vendosja në vendim e përcaktuar të veglave dhe instrumentave;
- Komunikimi me profesionalizëm dhe etikë profesionale.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik, mbrojtjes së mjedisit, mbrojtjes nga zjarri;
- Pastrimi i vendit të punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të identifikojë dokumentacionin teknik përkatës;
- të analizojë dokumentacionin teknik të agregatit për mirëmbajtje.
- të vlerësojë dhe përcaktojë punimet për t'u kryer dhe vendit;
- të marrë masat për sigurinë, shëndetin, kundra zjarrit dhe mjedisin përfshirë veshjet personale;
- të rrethojë vendin e punimeve për të mos-lejuar hyrjen e të pa-punëve;
- të krijojë rrugëkalimet e hyrje-daljes dhe përreth punimeve për mbikqyrje punimesh;
- të përgatisë veglat dhe instrumentat përkatës për punë;
- të plotësojë një formular për marjen e lejes për punime;
- të informojë qartë dhe të afishojë me shkrim personelin që ndikohet nga punimet dhe në hyrje të sektorit;

Për saldime në lamiera:

- të bëjë shënimet operative për të shtrirjes së zonës së dëmtuar për zëvendësim;
- të presë me kujdes lamierën e dëmtuar sipas shënimit;
- të presë me kujdes lamierën e re sipas përmasave të zonës së dëmtuar;
- të zmusojë mirë buzët e lamierës së re;
- të prezantojë në vend lamierën e re;
- të pikojë me saldim në pikat mbajtëse;
- të kryejë tegelin e saldimit në të gjithë perimetrin e saj;
- të pastrojë skorjet mbas saldimit me çekiç dhe furçe teli;
- të zmerilojë dhe lyejë me bojë lamierën mbas ftohjes;

Për saldime në tubacione:

- të mbyllë mirë saraçineskat komunikuese me sistemin e tubacionit të dëmtuar;
- të zmontojë me kujdes dhe rend dy flanxhat që përfshijnë zonën e tubacionit të dëmtuar;
- të përgatisë bazamentin prej hekuri me dy flanxha të tjera të ngjashme;
- të prezantojë tubacionin e dëmtuar brenda flanxhave të bazamentit;
- të fiksojë flanxhat e bazamentit me flanxhat e tubacionit të dëmtuar;
- të presë me kujdes zonën e dëmtuar/ndryshkur të tubacionit;
- të përgatisë me kujdes tubacionin e ri dhe zmusojë buzët;
- të prezantojë në vend tubacionin e ri;
- të pikojë dhe mbushë me saldim përreth në të dy pozicionet tubacionin;
- të pastrojë tubacionin nga skorjet e saldimit;
- të lyejë me bojë tubacionin mbas ftohjes;
- të zmontojë me kujdes nga bazamenti me flanxhat ku u përgatit tubacioni;
- të përgatisë guarnicionin e gomës për montimin e flanxhave;
- të montojë me kujdes pjesën e riparuar në vendin vet;
- të hapë saraçineskat dhe provojë për rrjedhje;

Të përgjithshme:

- të bëjë shënimet e sakta të punimeve të kryera dhe rezultateteve të provave në ditar;
- të informojë qartë përfundimin dhe rezultatet e punimeve;
- të lirojë pengesat rrethuese pas përfundimit të punimeve;
- të pastrojë dhe vendosë në vendin e përcaktuar të veglave dhe instrumentave;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë profesionale;
- të raportojë sasi të hidrokabureve
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit
- të pastrojë vendin e punës.

RM 4 Nxënësi kryen shërbime mirëmbajtëse/riparuese të thjeshta të pompës së ujit të detit të sistemit sanitar të anijes

Përmbajtja

- Identifikimi i dokumentacionit teknik përkatës.
- Analiza e skemës së agregatit për mirëmbajtje;
- Vlerësim dhe përcaktim i punimeve për t'u kryer dhe vendit;
- Marja e masave për sigurinë, shëndetin, kundra zjarrit dhe mjedisin përfshirë veshjet personale;
- Rrethimi vendit të punimeve;
- Krijimi i rrugëkalimeve hyrje-dalje dhe përreth punimeve;
- Përgatitje e veglave dhe instrumentave për punë;
- Marja e lejes për punime;
- Informimi i personelit që ndikohet nga punimet;
- Mbyllja e saraçineskave komunikuese me sistemin;
- Zmontimi i pompës nga vendi;
- Zmontimi në pjesë të saj;
- Pastrimi nga pa-pastërtitë dhe keqja e ndryshkut;
- Seleksionimi (kontrolli individual) i pjesëve të pompës për riparim;
- Evidentimi i pjesës së dëmtuar (p. sh. kushinetat);
- Heqja e kushinetave të dëmtuara;
- Zëvendësimi me kushineta të reja;
- Grasetimi i kushinetave dhe pjesëve të tjera të pompës;
- Montimi i pjesëve të pompës komplet;
- Montimi i pompës në vend me flaxhat hyrëse dhe dalëse;
- Hapja e saraçineskave hyrëse dhe dalëse;
- Prova e punës së pompës me ngarkesë;
- Kryerja e shënimeve në ditar;
- Informimi për përfundimin dhe rezultatet e punimeve;
- Lirimi i pengesave rrethuese pas përfundimit të punimeve;
- Pastrimi dhe vendosja në vendim të përcaktuar të veglave dhe instrumentave;
- Komunikimi me profesionalizëm dhe etikë profesionale.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik, mbrojtjes së mjedisit, mbrojtjes nga zjarri;
- Pastrimi i vendit të punës

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të identifikojë dokumentacionin teknik përkatës;
- të analizojë dokumentacionin teknik të agregatit për mirëmbajtje.
- të vlerësojë dhe përcaktojë punimet për t'u kryer dhe vendit;
- të marrë masat për sigurinë, shëndetin, kundra zjarrit dhe mjedisin përfshirë veshjet personale;
- të rrethojë vendin e punimeve për të mos-lejuar hyrjen e të pa-punëve;
- të krijojë rrugëkalimet e hyrje-daljes dhe përreth punimeve për mbikqyrje punimesh;
- të përgatisë veglat dhe instrumentat përkatës për punë;
- të plotësojë një formular për marjen e lejes për punime;
- të informojë qartë dhe të afishojë me shkrim personelin që ndikohet nga punimet dhe në hyrje të sektorit;
- të mbyllë mirë saraçineskat komunikuese me sistemin;
- të zmontojë me kujdes dhe rend pompën nga vendi;
- të zmontojë me kujdes dhe rend në pjesë i saraçineskës;
- të pastrojë saraçineskën nga pa-pastërtitë dhe kepë ndryshkun me furçe teli;
- të seleksionojë (kontroll individual) me kujdes pjesët e pompës për riparim;
- të evidentojë pjesën e dëmtuar (p. sh. kushinetat);
- të heqë me kujdes dhe rend kushinetat e dëmtuara;
- të vendosë në vend me kujd dhe rend kushineta të reja;
- të grasatojë me kujdes kushinetat dhe pjesët e tjera të pompës;
- të montojë me kujdes dhe rend pjesët e pompës komplet;
- të montojë me kujd dhe rend pompën në vend me flanaxhat hyrëse dhe dalëse;
- të hapë saraçineskat hyrëse dhe dalëse;
- të realizojë provat e punës së pompës me ngarkesë;
- të bëjë shënimet e sakta të punimeve të kryera dhe rezultateteve të provave në ditar;
- të informojë qartë për përfundimin dhe rezultatet e punimeve;
- të lirojë pengesat rrethuese pas përfundimit të punimeve;
- të pastrojë dhe vendosë në vendin e përcaktuar të veglave dhe instrumentave;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve në lokalitë e makinerisë
- të pastrojë vendin e punës..

**Udhëzime për
zbatimin e
modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në anije në port dhe në lundrim.
- Mësuesi/Mekaniku i caktuar për mbikqyrjen e punës së nxënësit duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrimet dhe demonstrimet konkrete të proceseve dhe raportimit përkatës për detyrat dhe situatat e paraqitura në lokalin e makinerisë.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete, në mbështetje të përvetësimit të njohurive që trajton moduli.
- Gjithashtu ata duhet të angazhohen në përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve që përdoren në proceset e punës në lokalin makinerisë së mjetit të lundrimit.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- anije në port
 - anije në lundrim për qëllime peshkimi apo tregtare
 - mjetet e punës të disponueshme në anije.
 - pankarta, makete, udhëzues, katalogë, rregullore, standarte, manuale teknike etj.
-

4. Moduli: “Krijimi, organizimi i veprimtarisë së ndërmarrjes për zënie/kultivim të produkteve ujore”

Drejtimi: Detari
Niveli: III
Klasa: 13

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	KRIJIMI, ORGANIZIMI I VEPRIMTARISË SË NDËRMARRJES PËZ ZËNIE/KUTIVIM TË PRODUKTEVE UJORE	M-17-1413-18
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të kryer veprimet dhe hartuar dokumentet e krijimit të ndërmarrjes për zënie/kultivim produktesh ujore, përcaktuar formën juridike të saj, për të rekrutuar personelin përkatës, për të realizuar kontabilizime të thjeshta të ndërmarrjes së zënies/kultivimit të peshkut (llogaritje ekonomike, kontabilizime dhe mbylljen vjetore, ndërtimin e pasqyrave financiare të veprimtarisë ekonomike të ndërmarrjes së zënies/kultivimit të produkteve ujore).	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kl.12 në një nga profilet e niv.II të drejtimit mësimor “Detari”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi kryen studimin fillestar për krijimin e ndërmarrjes së zënies/kultivimit të peshkut. Përmbajtja <ul style="list-style-type: none">- Përcaktimi i llojit të veprimtarisë dhe produkteve apo shërbimeve, që do të zihen/kultivohen dhe tregtohen.- Planifikimi i shitjeve dhe blerjeve.- Planifikimi i shpenzimeve dhe të ardhurave nga shitja.- Parashikimi i kostos për njësi produkti.- Planifikimi i kostove fikse të ndërmarrjes së zënies/kultivimit të peshkut.- Planifikimi i shpenzimeve të tjera të ndryshueshme.- Shqyrtim dhe marje në konsideratë i skemave të subvencionit për hidrokarburet/kultivimin artificial;- Parashikimi i rezultatit ekonomik.- Hartimi i planit të biznesit.- Përcaktimi i nevojës për financime. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përcaktojë llojin e veprimtarisë dhe produkteve apo shërbimeve, që do të zihen/kultivohen dhe tregtohen.	

- të planifikojë sasinë e shitjeve dhe blerjeve, që do të realizojë mjeti i gjuetisë/kultivohen;
- të planifikojë shpenzimet dhe të ardhurat nga shitja.
- të parashikojë kostot për njësi të produktit, qoftë e mirë ose shërbim që do të ofrohet;
- të planifikojë kostot fikse të ndërmarrjes pronare/menaxhere e mjetit të gjuetisë detare/kultivimit artificial, për ushtrimin e veprimtarisë;
- të planifikojë shpenzimeve të tjera të ndryshueshme, në varësi të llojit të aktivitetit;
- tshqyrtojë dhe marrë parasysh skemat e subvencionit për hidrokarburet/kultivimin artificial;
- të parashikojë rezultatin ekonomik, mbi bazën e treguesve të mësipërm;
- të hartojë planin e biznesit, duke përmbledhur në të të gjitha parashikimet e kryera;
- të planifikojë saktë nevojat për financime, duke u mbështetur mbi planin e biznesit.

RM 2 Nxënësi përcakton formën juridike të ndërmarrjes për gjuetinë e peshkut në det dhe dokumentacionin bazë të saj.
Përmbajtja

- Përzgjedhja e formës juridike.
- Plotësimi i dokumentacionit për krijimin e ndërmarrjes për zënie/kultivimin artificial të peshkut.
- Hartimi i një statuti dhe akti të thjeshtë themelimi.
- Përcaktimi i mënyrës për derdhjen e kapitalit fillestar.
- Përcaktimi i strukturës organizative.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë formën juridike më të përshtatshme për ndërmarrjen e zënies/kultivimit të peshkut, sipas mundësive të financimit dhe kërkesave të pronarëve;
- të plotësojë dokumentacionin për krijimin e ndërmarrjes, sipas formës së saj juridike, duke shfrytëzuar burimet e duhura;
- të hartojë një statut dhe një akt të thjeshtë të themelimit të ndërmarrjes për zënie/kultivimin artificial të peshkut;
- të përcaktojë saktë dhe qartë mënyrën se si do të bëhet derdhja e kapitalit fillestar të ndërmarrjes për zënie/kultivimin artificial të peshkut;
- të përcaktojë strukturën organizative të ndërmarrjes për zënie/kultivimin artificial të peshkut, sipas formës juridike të saj.

RM 3 Nxënësi aplikon për regjistrim dhe liçensim në organet përkatëse.

Përmbajtja

- Plotësimi i formularëve të aplikimit për regjistrim dhe licensim.
- Plotësimi i dokumentave të aplikimit
- Liçencimi pranë qendrave përkatëse
- Marrja e certifikatave të liçensimit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të plotësojë saktë formularët e aplikimit.
- të plotësojë të gjithë dokumentet që duhet të shoqërojnë aplikimin në qendrat e regjistrimit dhe liçensimit të biznesit
- të regjistrohet dhe liçensohet pranë organeve përkatëse, duke ndjekur afatet;
- të marrë në dorëzim certifikatat e regjistrimit dhe liçensimit (NIPT).

RM 4 Nxënësi identifikon nevojat për personel të ndërmarrjes së zënies/kultivimit të Produkteve ujore.

Përmbajtja

- Mbledhja e informacionit për personel.
- Analizimi i kërkesave për personel.
- Përcaktimi i nevojave për personel.
- Hartimi i formularëve përmbledhës.
- Marrja e vendimit për personel.
- Përcaktimi i dokumenteve dhe kriterëve të nevojshme për punësim.
- Reklamimi i vendeve të lira të punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të mbledhë informacion të saktë dhe të plotë nga sektorët e ndërmarrjes për nevojat për personel;
- të analizojë saktë dhe me përgjegjshmëri kërkesat e sektorëve për personel;
- të përcaktojë saktë nevojat për personel të ri, sipas sektorëve të ndërmarrjes ushqimore;
- të hartojë formularët përmbledhës për personelin e ri;
- të marrë vendimin përfundimtar për personel të ri, sipas analizës së nevojave.
- të përcaktojë dokumentet dhe kriteret e nevojshme për vendet e lira të punës, sipas standardeve të kërkuara (Kërkesë punësimi, CV, dokumente vërtetuese të aftësive profesionale dhe personale të kandidatit);
- të reklamojë, sipas standardeve, vendet e lira të punës në media.

RM 5 Nxënësi kryen procedurat e rekrutimit dhe punësimit të personelit në shtëpi të zënieve/kultivimit të produkteve ujore.

Përmbajtja

- Pranimi i dosjeve të kandidatëve.
- Analizimi i dosjeve.
- Seleksionimi i dosjeve të kandidatëve.
- Hartimi i kriterëve të vlerësimit.
- Përgatitja e intervistave.
- Realizimi i intervistave.
- Marrja e vendimeve.
- Informimi i rezultateve të përzgjedhjes.
- Hartimi i kontratës së punës.
- Nënshkrimi i kontratës së punës.
- Regjistrimi në regjistrin themeltar të njësisë ekonomike.
- Regjistrimi në institucionet përkatëse.
- Regjistrimi i personelit të ri në librin e pagave.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Kontrolli i dosjes personale e nxënësit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të pranojë dosjet e kandidatëve, sipas afatit kohor;
- të analizojë dosjet e kandidatëve për vendet e lira të punës;
- të seleksionojë dosjet e kandidatëve, sipas kriterëve;
- të hartojë kriteret e vlerësimit për kandidatët, sipas vendit të kërkuar të punës;
- të përgatisë intervista për kandidatët, duke saktësuar kriteret;
- të realizojë me profesionalizëm intervistat me kandidatët;
- të marrë vendimet për përzgjedhjen e kandidatëve, sipas vlerësimit objektiv të dokumenteve e intervistave të tyre;
- të informojë rezultatet e përzgjedhjes së personelit sektorëve përkatës;
- të hartojë kontratën e saktë të punës, duke u bazuar në legjislacionin dhe kodin e punës;
- të nënshkruajë kontratën e punës ndërmjet palëve;
- të regjistrojë personelin e ri në regjistrin themeltar të ndërmarrjes;
- të regjistrojë personelin e ri në zyrën e punës, sigurimet shoqërore dhe institutin e sigurimeve shëndetësore, duke e pajisur me librezat përkatëse;
- të regjistrojë personelin e ri në librin e pagave dhe shpërblimeve.

RM 6 Nxënësi regjistron në kontabilitet veprimet për krijimin e ndërmarrjes së zënieve/kultivimit të produkteve ujore.

Përmbajtja

- Regjistrimi kontabël i kapitalit fillestar.
- Regjistrimi kontabël i shpenzimeve të krijimit dhe regjistrimit.
- Hartimi në kompjuter i regjistrave.

- Kryerja e artikullit të çeljes.
- Çelja e kartelave të magazinës

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë saktë regjistrimin kontabël të kapitalit fillestar të dedhur nga pronarët për krijimin/zgjerimin e ndërmarrjes së zënies/kultivimit të peshkut;
- të kryejë saktë regjistrimin kontabël të shumave të shpenzimeve të paguara paraprakisht për krijimin, regjistrimin, asistencën ligjore si dhe për zgjerimin e veprimtarisë, sipas formës juridike të ndërmarrjes së zënies/kultivimit të peshkut;
- të hartojë saktë në kompjuter regjistrat kontabël (ditarin, librin e madh, partitarët, ditarët analitikë) në formë modelesh, për veprimtarinë e ndërmarrjes së zënies/kultivimit të peshkut;
- të kryejë saktë regjistrimin kontabël të gjëndjeve të bilancit fillestar (artikulli i çeljes) në ditar;
- të kryejë saktë çeljen e kartelave të magazinës, sipas formatit të përcaktuar

RM 7 Nxënësi regjistron në kontabilitet blerjet dhe shitjet e produkteve së zënies/kultivimit të produkteve ujore.

Përmbajtja:

- Çelja e ditarit analitik të blerjeve.
- Regjistrimi kontabël i faturave të blerjeve.
- Regjistrimi kontabël në shtim të gjendjes së produkteve.
- Regjistrimi kontabël i faturave të blerjeve në regjistrin e faturave të marra.
- Çelja e ditarit analitik të shitjeve.
- Regjistrimi kontabël i faturave të shitjeve.
- Regjistrimi kontabël në pakësim të gjendjes së produkteve.
- Regjistrimi i faturave në regjistrin e faturave të emetuara.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të çelë ditarin analitik të blerjeve, duke respektuar normativat ligjore në fuqi;
- të regjistrojë saktë faturat e blerjes së produkteve në ditarin analitik të blerjeve;
- të kryejë regjistrimin e saktë kontabël në shtim të gjendjes së produkteve në magazinë;
- të kryejë regjistrimin e saktë të faturave të blerjeve në regjistrin e faturave të marra.
- të çelë ditarin analitik të shitjeve, duke respektuar normativat ligjore në fuqi;
- të regjistrojë saktë faturat e shitjeve të produkteve në ditarin analitik të shitjeve;

- të kryejë regjistrimin kontabël, në pakësim, të gjendjes së produkteve;
- të regjistrojë saktë faturat e shitjeve në regjistrin e faturave të emetuara.

RM 8 Nxënësi kryen veprimeve për plotësimin e listëpagesave dhe librit të ndërmarrjes së zënies/kultivimit të produkteve ujore.

Përmbajtja

- Hartimi i listëpagesës.
- Regjistrimi i pagave bruto.
- Llogaritja dhe regjistrimi i ndalesave.
- Llogaritja dhe regjistrimi i pagave neto.
- Regjistrimi i pagave neto
- Plotësimi i listëpagesave.
- Plotësimi i librit të pagave.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të hartojë listëpagesën e pagave, duke pasqyruar të gjitha detyrimet sipas legjislacionit shqiptar;
- të regjistrojë në listëpagesë shpërblimet bruto të llogaritura të punëmarrësve;
- të llogarisë saktë të regjistrojë në listëpagesa ndalesat për sigurimet shoqërore dhe tatimet nga të ardhurat e personelit, në përputhje me legjislacionit shqiptar;
- të llogarisë saktë, në listëpagesën e sigurimeve, kontributin që përballohet nga punëmarrësi, në përputhje me normativat ligjore në fuqi.
- të plotësojë listëpagesat e shpërblimeve, sigurimeve për çdo të punësuar dhe pagesat për ditët me raport, të përballuara nga ndërmarrja e zënies/kultivimit të peshkut dhe nga ISSH;
- të plotësojë në librin e pagave shpërblimet, sigurimet e llogaritura dhe paguara për çdo të punësuar, pagesat për ditët me raport, të përballuara nga ndërmarrja e zënies/kultivimit të peshkut dhe nga ISSH.
- të regjistrojë, saktë, duke u bazuar në listëpagesën e pagave shpenzimet e punës, detyrimet ndaj personelit, sigurimeve dhe shtetit për TAP;

RM 9 Nxënësi rregullon marrëdhënien me ISSH dhe tatimet.

Përmbajtja

- Plotësimi i deklaratës mujore të sigurimeve shoqërore.
- Plotësimi On-Line i sigurimeve shoqërore.
- Kontrolli i përputhjes së deklaratës me listëpagesat e sigurimeve shoqërore.
- Plotësimi i urdhërshirimit të sigurimeve.
- Hartimi i deklaratave mujore për TAP të personelit.

- Paraqitja e deklaratave mujore pranë organeve tatimore.
- Plotësimi i UXH për shpërblimet e punës dhe TAP.
- Përcjellja e urdhërshirimeve për ekzekutim.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të plotësojë deklaratën mujore të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit shqiptar;
- të plotësojë On-line deklaratën e sigurimeve shoqërore;
- të kryejë kontrollin e plotë të përputhjes së deklaratës me listëpagesat përmbledhëse të sigurimeve;
- të plotësojë saktë UXH e sigurimeve shoqërore shumë analitike të llogaritura për çdo zë sigurimesh;
- të hartojë saktë dhe qartë deklaratat mujore të TAP.
- të kryejë, saktë, procedurat e paraqitjes së deklaratave mujore, pranë organeve tatimore;
- të plotësojë saktë UXH dhe dokumentacionin e plotë të nevojshëm, për pagesën e shpërblimeve të punës;
- të përcjellë, në kohë, në bankë dokumentet dhe urdhërshirimet e pagesës së shpërblimeve, kuotave të sigurimeve dhe TAP (tatim mbi të ardhurat personale).

RM 10 Nxënësi kryen veprimet e mbylljes dhe hartimit të bilancit përfundimtar të ndërmarrjes së zënies/kultivimit të produkteve ujore.

Përmbajtja

- Regjistrimi i përmbledhjes së shpenzimeve.
- Regjistrimi i përmbledhjes së të ardhurave.
- Hartimi i bilancit vërtetues.
- Llogaritja e rezultatit të ndërmarrjes së zënies/kultivimit të peshkut.
- Hartimi i bilancit përfundimtar.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të regjistrojë saktë përmbledhjen e shpenzimeve;
- të regjistrojë saktë përmbledhjen e të ardhurave;
- të hartojë, saktë, bilancin vërtetues;
- të llogarisë, saktë, rezultatit ekonomik të ndërmarrjes së zënies/kultivimit të peshkut;
- të hartojë, saktë, bilancin e veprimtarisë së ndërmarrjes së zënies/kultivimit të peshkut, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në mjediset e firmës ushtrimore ku Qendra Shqiptare e Firmave Ushtrimore (ALCT) do të luajë rolin e “shtetit”.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e

mundur ilustrime dhe demonstrime konkrete të proçeseve për studimin fillestar për krijimin e ndërmarrjes për zënien/kultivimin artificial të produkteve ujore, për përcaktimin e formës juridike dhe dokumentacionit bazë të saj, për identifikimin e nevojave për personel, rekrutimin e punësimin e tij, të dokumenteve dhe formularëve të marrë nga praktika e ndërmarrjeve ekonomike;

- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për studimin fillestar për krijimin e ndërmarrjes, për përcaktimin e formës juridike dhe dokumentacionit bazë të saj, për identifikimin e nevojave për personel, rekrutimin e punësimin e tij, për kryerjen e llogaritjeve ekonomike, regjistrimet dhe mbylljen vjetore, për ndërtimin e pasqyrave financiare të veprimtarisë ekonomike të ndërmarrjes.
- Mësuesi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe pajisjeve të punës.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për studimin fillestar për krijimin e ndërmarrjes, për përcaktimin e formës juridike dhe dokumentacionit bazë të saj, për identifikimin e nevojave për personel, si dhe rekrutimin e punësimin e tij, për kryerjen e llogaritjeve ekonomike, regjistrimet dhe mbylljen vjetore, për ndërtimin e pasqyrave financiare të veprimtarisë ekonomike të ndërmarrjes.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për realizimin e procedurave për krijimin, organizimin e ndërmarrjes, për kryerjen e llogaritjeve ekonomike, regjistrimeve dhe mbylljen vjetore, për ndërtimin e pasqyrave financiare të veprimtarisë ekonomike të ndërmarrjes së zënies/kultivimit të produkteve ujore.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- mjedis i firmës ushtrimore;
 - mjetet dhe pajisjet e punës, për krijimin e organizimin e nd/jes;
 - mjete kancelarie, kompjuter ne lidhje me internetin.
 - program kompjuterik për menaxhimin e aktivitetit në ndërmarrje për zënien/kultivimin artificial të peshkut.
 - modele statutesh, aktesh themelimi, planesh biznesi, dosjesh aplikimi në qendrat për regjistrim dhe liçensim, të marra nga ndërmarrje konkrete, për krijimin dhe organizimin e ndërmarrjes;
 - formularë regjistrimi dhe liçensimi;
 - pasqyra dhe deklarata për numrin e të punësuarve, kontrata me sigurimet shoqërore e shëndësore , deklarata të parashikimit të fitimit etj.
 - dokumente të ndryshme financiare, model nga ndërmarrjet reale dhe të përgatitura nga mësuesi;
-

-
- mjete kancelarie, kompjuter ne lidhje me internetin;
 - formularë, pasqyra financiare, libra financiarë të detyrueshëm, të marra nga praktika ose përpunuar në modulet e mëparshme;
 - materiale të ndryshme informative të marra nga Qendra Shqiptare e Firmave Ushtrimore (ALCT).
-

5. Moduli: “Promocioni dhe veprime të shitblerjes së produkteve ujqre”

Drejtimi: Detari
Niveli: III
Klasa: 13

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	PROMOCIONI DHE VEPRIME TË SHITBLERJES SE PRODUKTEVE UJORE	M-17-1414-18
Qëllimi i modulit	Një modul, që i pajis nxënësit me aftësi praktike për të kryer politikën e produktit të saj, të promocionit të imazhit të ndërmarrjes dhe, aplikime për pjesëmarrje në panaire, hartimin e materialeve promovuese, përfshirë procedurën e shitblerjes, në kushtet e një tregu edhe ndërkombëtar dhe konkurrues, si dhe për të dokumentuar dhe regjistruar blerjet dhe shitjet.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kl.12 në një nga profilet e niv.II të drejtimit mësimor “Detari”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi analizon furnitorët potencialë në fushën e biznesit dhe vendos marrëdhënie me ta. Përmbajtja <ul style="list-style-type: none">- Kërkimi i informacioneve për furnitorë vendas dhe të huaj;- Identifikimi dhe hartimi i listave përmbledhëse të furnitorëve potencialë;- Shqyrtimi i produkteve që ofrohen nga furnitorë potencialë.- Hartimi i statistikave përmbledhëse të furnitorëve aktualë.- Identifikimi i blerjeve në materiale dhe vegla pune;- Vendosja e marrëdhënieve me firmat korrespondente dhe kërkesa për ofertat.- Përgatitja e porosive dhe llogaritja sasiore e produkteve për blerje; Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të kërkojë me kujdes informacione për furnitorë vendas;- të kërkojë, në mënyrë të orientuar nga qëllimi, informacione për furnitorë në tregun ndërkombëtar duke përdorur internetin;- të identifikojë furnitorët potencialë, me të njëjtin objekt veprimtarie me ndërmarrjen dhe të hartojë lista përmbledhëse me informacione të qarta dhe të plota të furnitorëve potencialë të identifikuar;	

-
- të shqyrtojë produktet e furnitorëve potencialë, për periudhat e kaluara, duke identifikuar qartë furnitorët aktualë;
 - të hartojë statistika të sakta dhe të plota përmbledhëse me informacione për furnitorët aktuale, mbi bazën e veprimeve dhe vëllimit të shitjeve të realizuar me ta.
 - të identifikojë saktë blerjet, të cilat do të kryhen pranë furnitorëve (firmave) korrespondentë;
 - të vendosë marrëdhënie të qarta dhe korrekte me furnitorët korrespondente, duke kërkuar oferta nga furnitorët me lista çmimesh për produkte.
 - të përgatisë porositë përkatëse për produktet që do të blihen, në bazë të nevojave për blerje, duke llogaritur sipas llojeve, sasisë e produkteve që do të blihen pranë firmave korrespondente, për të plotësuar nevojat e shitjeve në markatën e peshkut.

RM 2 Nxënësi identifikon nevojat dhe furnitorët për blerje për personelin.

Përmbajtja

- Hartimi i formularëve të nevojave për personel.
- Komunikimi me personelin.
- Shpërndarja e formularëve.
- Plotësimi i formularit.
- Mbledhja e formularëve.
- Hartimi i formularit përmbledhës.
- Përcjellja e formularit përmbledhës.
- Përpunimi i nevojave të personelit
- Shqyrtimi i kartelave të furnitorëve aktualë.
- Kërkimi i informacionit.
- Identifikimi i furnitorëve të rinj potenciale

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të hartojë saktë formularët e nevojave për blerje për personelin, ku të parashikohet detajimi i kërkesave të kryera;
- të komunikojë me personelin e ndërmarrjes, për deklarimin e nevojave të tyre për blerje;
- të shpërndajë formularët personelit;
- të plotësojë saktë formularin, sipas nevojave për blerje;
- të mbledhë formularët e plotësuar me nevojat e personelit për blerje;
- të hartojë formularin përmbledhës me informacionin e marrë;
- të përcjellë në kohë formularin përmbledhës për porositjen e blerjeve për personel.
- të përpunojë saktë nevojat e personelit për blerje, sipas kërkesave të bëra;
- të shqyrtojë kartelat e furnitorëve aktualë të blerjeve për personelin, duke identifikuar qartë furnitorët potencialë,

- nga mund të kryhen blerjet;
- të kërkojë informacione në treg për furnitorë të rinj potencialë, nëpërmjet materialeve në internet;
- të identifikojë saktë furnitorë potencialë vendas dhe të huaj, të cilët mund të plotësojnë nevojat e personelit dhe karakteristikat e produktit të tyre.

RM 3 Nxënësi kryen blerjet dhe regjistrimin e tyre për biznesin dhe personelin

Përmbajtja

- Përcaktimi i nevojave për blerje për biznesin dhe personelin.
- Hartimi i urdhërave të blerjes
- Kërkimi i ofertave për blerje
- Marrja e ofertave
- Regjistrimi i ofertave
- Plotësimi i formularit të krahasimit të ofertave.
- Krahasimi i ofertave
- Përzgjedhja e ofertës më të mirë.
- Kryerja e porosisë së blerjes.
- Regjistrimi i porosisë së blerjes.
- Plotësimi i dëftesës së lëvrimit dhe faturës.
- Kontrolli i përputhjes së porosisë së blerjes me dëftesën e lëvrimit dhe faturën.
- Përcjellja e dokumenteve për pagesë në sektorin e kontabilitetit.
- Reklamimi i produkteve të blera.
- Kryerja e regjistrimeve në kartelat e furnitorëve.
- Regjistrimi i blerjeve

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë nevojat për blerje për biznesin dhe personelin, duke kontrolluar gjendjen e produkteve në magazinë;
- të hartojë urdhra të saktë blerjeje
- të kërkojë oferta nga furnitorët që tregtojnë produktet e kërkuara;
- të marrë ofertat për blerje nga furnitorët;
- të regjistrojë saktë ofertat e marra nga furnitorët;
- të plotësojë saktë formularin e krahasimit të ofertave të marra;
- të krahasojë ofertat e marra, në bazë të llogaritjeve;
- të përzgjedhë ofertën më të mirë;
- të kryejë saktë porosinë për blerje;
- të regjistrojë saktë porosinë për blerje në regjistrin e porosive të kryera;
- të plotësojë saktë dëftesën e lëvrimit dhe faturën e produkteve të blera për personelin dhe veprimtarinë e biznesit;
- të kontrollojë përputhshmërinë e porosisë së blerjes me

- dëftesën e lëvrimin dhe faturën përkatëse;
- të përcjellë në kohë dokumentet e blerjeve në zyrën e kontabilitetit;
- të reklamojë në kohën e duhur produktet që nuk përputhen me kontratat ose janë të dëmtuara;
- të kryejë saktë regjistrimet e blerjeve në kartelat e furnitorëve;
- të regjistrojë blerjet për veprimtarinë e biznesit në kartelat e magazinës;

RM 4 Nxënësi analizon klientët potencialë në fushën e biznesit.

Përmbajtja

- Kërkimi i informacioneve për klientët vendas.
- Kërkimi i informacioneve për klientë të huaj.
- Identifikimi i klientëve potencialë.
- Hartimi i listave përmbledhëse të klientëve potencialë.
- Shqyrtimi i kartelave të klientëve potencialë.
- Hartimi i statistikave përmbledhëse të klientëve aktualë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kërkojë me kujdes informacione për klientë vendas;
- të kërkojë, në mënyrë të orientuar nga qëllimi, informacione për klientë në tregun ndërkombëtar, duke përdorur internetin;
- të identifikojë klientët potencialë, me objekt veprimtarie konsumin e produkteve ujore;
- të hartojë lista përmbledhëse me informacione të qarta dhe të plota të klientëve potencialë të identifikuar;
- të shqyrtojë kartelat e klientëve potencialë, për periudhat e kaluara, duke identifikuar qartë klientët aktualë;
- të hartojë statistika të sakta dhe të plota përmbledhëse me informacione për klientët aktuale, mbi bazën e veprimeve dhe vëllimit të shitjeve të realizuar me ta.

RM 5 Nxënësi nxit mardhëniet me klientët potencialë dhe aktualë

Përmbajtja

- Përgatitja e materialeve informative për klientët.
- Reklamimi i materialeve informative të ndërmarrjes.
- Përpunimi i informacioneve të marra nga klientët.
- Hartimi i listave të klientëve.
- Dërgimi i informacioneve të plota klientëve.
- Dërgimi i ofertave të veçanta.
- Dërgimi i anketimeve për kërkesa të veçanta të klientëve.
- Hartimi i planit të detajuar të përmbushjes së kërkesave.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë, në bashkëpunim me sektorin e marketingut materialet informative që u dërgohen klientëve;
- të reklamojë, nëpërmjet internetit, materialet informative të ndërmartjes për vendosjen e marrëdhënieve të biznesit me klientët;
- të përpunojë saktë informacionet e marra nga klientët e kontaktuar, që kanë shfaqur interes;
- të hartojë lista të plota të klientëve me të cilët parashikohet të vazhdohen marrëdhëniet e biznesit;
- të dërgojë informacione të plota klientëve mbi listën e çmimeve dhe katalogëve;
- të dërgojë oferta të veçanta, për ulje çmimi, kushte të veçanta lëvrimi e pagese, dhurata, etj;
- të dërgojë anketime për kërkesa të veçanta të klientëve;
- të hartojë planin e detajuar të përmbushjes së kërkesave të klientëve.

RM 6 Nxënësi kryen shitjet dhe regjistrimet përkatëse.

Përmbajtja

- Hartimi i kontratave të shitblerjes
- Përpunimi i kërkesave të klientëve.
- Regjistrimi i porosive të klientëve.
- Kontrolli i gjendjes së produkteve.
- Dërgimi i njoftimeve për plotësimin e gjendjes së produkteve.
- Hartimi i dëftesave të lëvrimin dhe fletëdaljeve.
- Hartimi i faturave të shitjes.
- Regjistrimi i ekzekutimit të porosive.
- Plotësimi i kartelave individuale të klientëve.
- Regjistrimi i pakësimit të gjendjeve të produkteve të shitura.
- Dërgimi i dokumenteve për regjistrim.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të hartojë kontratat e shitblerjes, mbi bazë e elementëve ligjorë;
- të përpunojë kërkesat e klientëve;
- të regjistrojë saktë porositë e mbërritura nga klientët;
- të kontrollojë gjendjen e produkteve sipas cilësisë dhe sasisë së tyre;
- të dërgojë njoftimet sektorit të blerjeve, për plotësimin e gjendjes së produkteve, në rast se ato nuk disponohen;
- të hartojë saktë dëftesat e lëvrimin dhe fletëdaljet e produkteve për t'u shitur;
- të hartojë saktë faturat e shitjes së produkteve;
- të regjistrojë, saktë, ekzekutimin e porosive të klientëve;
- të plotësojë kartelat individuale të klientëve;
- të regjistrojë saktë pakësimin e gjendjes së produkteve të shitura në kartelat e magazinës/frigoriferit;

- të dërgojë, brenda afateve, në zyrën e kontabilitetit dokumentet e shitjes për ndjekjen e arkëtimeve.

RM 7 Nxënësi kryen blerje dhe shitje për biznesin dhe personelin në Web-shop (markatën elektronike).

Përmbajtja

- Kërkimi i informacionit në Web-shop (markatën elektronike).
- Identifikimi i produkteve për blerje.
- Krahasimi i ofertave dhe kushteve të lëvrimit të pagesës.
- Përzgjedhja e ofertës.
- Kryerja e porosisë për blerje.
- Kryerja e ruajtjes elektronike dhe printimit të porosisë për blerje.
- Regjistrimi dhe përcjellja e porosisë së blerjes për përdorime të mëtejshme.
- Kontrolli i porosive në faqen e Web-shop (markatën elektronike).
- Përpunimi dhe regjistrimi i porosive.
- Konfirmimi dhe ruajtja elektronike e porosisë së marrë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kërkojë informacion për firmat në Web-shop, për nevojat për blerje të ndërmarrjes, të orientuara sipas produkteve të kërkuara për blerje;;
- të identifikojë saktë produktet që do të porositen,
- të krahasojë ofertat dhe kushtet e lëvrimit e të pagesës së tyre;
- të përzgjedhë saktë ofertën më të mirë;
- të kryejë saktë porosinë për produktet që do të blihen;
- të kryejë ruajtjen elektronike dhe printimin e porosisë së kryer;
- të regjistrojë saktë porosinë në regjistrin e porosive të kryera;
- të përcjellë në kohë porosinë për blerje, për përdorime të mëtejshme, duke zbatuar të njëjtën procedurë me atë të blerjeve të tjera.
- të kontrollojë rubrikën e porosive në faqen e Web-shop, duke identifikuar saktë porositë e reja që duhet të përpunohen;
- të përpunojë dhe të regjistrojë saktë porositë e reja në regjistrin e tyre, duke ndjekur të njëjtën procedurë me atë të shitjeve në forma të tjera;
- të dërgojë në formë elektronike konfirmimin për marrjen e porosisë;
- të ruajë porosinë në formën e përshtatshme elektronike, për t'a përdorur për qëllime të mëtejshme.

RM 8 Nxënësi realizon politikën e produktit të ndërmarrjes së zënies/kultivimit të peshkut.

Përmbajtja

- Parashikimi i produkteve që do të shiten nga ndërmarrja e zënies/kultivimit të peshkut.
- Parashikimi i produkteve të reja.
- Parashikimi i kostove për produktet e reja.
- Llogaritjet parashikuese të çmimeve për produktet e reja.
- Llogaritjet e efektivitetit të produkteve të reja.
- Marrja e vendimeve mbi produktet e reja.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të parashikojë produktet që do të shiten nga ndërmarrja e zënies/kultivimit të peshkut, pas studimit të saktë dhe të kujdesshëm të tregut;
- të parashikojë produkteve të reja, që ndërmarrja e zënies/kultivimit të peshkut do hedhë në treg, në bazë të studimit të tregut;
- të parashikojë kostot e produkteve të reja;
- të kryejë llogaritje parashikuese të çmimeve për produktet e reja;
- të kryejë llogaritje të efektivitetit të produkteve të reja dhe të ndikimit të tyre në performancën e ndërmarrjes e zënies/kultivimit të peshkut;
- të marrë vendim të argumentuar për përfshirjen, ose jo në asortiment të produkteve të reja, të marra në studim.

RM 9 Nxënësi realizon reklamën e ndërmarrjes së zënies/kultivimit të peshkut dhe të produkteve ujore

Përmbajtja

- Përcaktimi i grupit të synuar.
- Ideimi i imazhit të ndërmarrjes dhe produktit të saj.
- Krijimi i logos së ndërmarrjes së zënies/kultivimit të peshkut.
- Formulimi i sloganit të ndërmarrjes/produktit.
- Hartimi i planit të masave për promovimin e ndërmarrjes së zënies/kultivimit të peshkut;
- Hartimi i formularëve dhe dokumenteve me logon dhe ngjyrat e ndërmarrjes së zënies/kultivimit të peshkut.
- Përzgjedhja e teknikave të reklamimit
- Realizimi i materialeve informative promovuese.
- Formulimi i sloganit të fushatës së reklamës;
- Prezantimi i reklamës së krijuar.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë drejt grupin e synuar, në varësi të tregut të ndërmarrjes së zënies/kultivimit të peshkut;
- të ideojë imazhin e ndërmarrjes dhe produktit, për të përcjellë mesazhin e duhur tek klientët;
- të krijojë logon e ndërmarrjes, në përshtatje me objektin e veprimtarisë dhe imazhin e konceptuar, duke përdorur teknika të ndryshme të animacionit në PC;
- të formulojë sloganin e ndërmarrjes së zënies/kultivimit të peshkut, në përputhje me imazhin e konceptuar;
- të hartojë një plan të qartë dhe të detajuar të masave, për promovimin e ndërmarrjes së zënies/kultivimit të peshkut;
- të hartojë formularë dhe dokumente me logon dhe ngjyrat e ndërmarrjes/produktit, për t'u përdorur gjatë veprimtarisë së ndërmarrjes;
- të përzgjedhë njërën nga teknikat e reklamimit, në përputhje me segmentimin e detajuar të tregut, për formulimin saktë të mesazhit të reklamës;
- të realizojë fletëpalosje, katalogë dhe materiale të tjera të shkruara për të promovuar ndërmarrjen dhe produktin, duke përdorur teknika të ndryshme të animacionit në PC;
- të kontribuojë në formulimin e sloganit të fushatës së reklamës;
- të prezantojë, sipas rregullave, reklamën e krijuar.

RM 10 Nxënësi kryen veprime përgatitore për pjesëmarrjen në panair

Përmbajtja

- Hartimi i kërkesës për pjesëmarrje në panair.
- Dërgimi i kërkesës tek organizatorët e panairit.
- Hartimi i sloganit me të cilin “firma” do të paraqitet në panair.
- Hartimi i kontratave të shitblerjes
- Hartimi i pasqyrave të shpenzimeve.
- Hartimi i listës së materialeve të nevojshme për realizimin e pjesëmarrjes në panair.
- Ndarja e detyrave dhe përgjegjësisive.
- Aplikimi i ndërmarrjes për pjesëmarrjen në panair.
- Marrja e njoftimit për pjesëmarrje në panair.
- Kryerja e studimeve për shitjet dhe blerjet e realizuara në panairin e kaluar.
- Kontrolli i gjendjeve të llogarisë rrjedhëse të “firmës” dhe personelit.
- Printimi i dëftesave të lëvrimit dhe faturave për shitjet.
- Hartimi i planit të ndërtimit të stendës së panairit.
- Përgatitja e prezantimeve elektronike.
- Sigurimi i veshjeve të nxënësve për panairin.
- Përpunimi i materialeve të shkruara informative.
- Printimi i materialeve të hartuara.
- Përcaktimi i personave përgjegjës dhe detyrave gjatë panairit.

- Planifikimi i bisedave të shitjes.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të hartojë kërkesën për pjesëmarrje në panair
- të dërgojë kërkesën tek organizatorët e panairit, të shoqëruar me informacionet e kërkuara për ndërmarrjen së zënies/kultivimit të peshkut;
- të hartojë sloganin me të cilin “firma” do të paraqitet në panair.
- të hartojë kontratat e shitblerjes që do të përdoren në panair;
- të hartojë pasqyrat e shpenzimeve sipas llojeve të tyre;
- të hartojë listën e materialeve të nevojshme për realizimin e pjesëmarrjes në panair;
- të ndajë detyrat dhe përgjegjësitë, duke përcaktuar afatet kohore të realizimit të tyre;
- të aplikojë për ndërmarrjen, si pjesëmarrëse në panair duke dërguar informacionet e duhura, që kërkohen nga organizatorët e panairit;
- të marrë njoftimin për pjesëmarrje në panair, së bashku me informacionin e vendodhjes së stendës së firmës, orarin e panairit, dokumentacionin e sigurimit të tij, listën e firmave pjesëmarrëse në panair;
- të kryejë studime në bazë të statistikave lidhur me shitjet dhe blerjet e realizuara në panairin e kaluar;
- të kontrollojë gjendjen e llogarisë rrjedhëse të “firmës” dhe personelit.
- të printojë dëftesat e lëvrimin dhe faturat për shitje, pasi i ka përgatitur ato;
- të hartojë planin e ndërtimit të stendës së panairit;
- të përgatisë prezantimet elektronike ose reklamën filmike për panair;
- të sigurojë veshjet e nxënësve për panairin, në përshtatje me identitetin e ndërmarrjes ushqimore dhe produktit;
- të përpunojë materiale të shkruara informative (katalogë, fletëpalosje, oferta speciale për panair, kartvizita, etj)
- të printojë materialet informative të përpunuara për panair;
- të përcaktojë personat përgjegjës dhe detyrat e tyre gjatë panairit;
- të planifikojë bisedat e shitjes për panair.

RM 11 Nxënësi kryen veprime gjatë panairit

Përmbajtja

- Regjistrimi i ndërmarrjes së zënies/kultivimit të peshkut.
- Firmosja e rregullores së panairit.
- Marrja në dorëzim e materialeve të porositura.
- Marrja në dorëzim e kartave të kreditit
- Ndërtimi i stendës.

- Vendosja e materialeve reklamuese në stendë.
- Përgatitja e tavolinës së prezantimit.
- Mirëmbajtja e mjedisit të stendës.
- Promocioni në stendë.
- Promocioni në sallën e panairit.
- Lidhja e kontratave për blerje e shitje në periudha të ardhshme.
- Kryerja e blerjeve.
- Kryerja e shitjeve
- Plotësimi i formularit përmbledhës të shitjeve.
- Dorëzimi i formularit përmbledhës së shitjeve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të regjistrojë ndërmarrjen në zyrën e informacionit të panairit
- të firmosë rregulloren e panairit;
- të marrë në dorëzim materialet e porositura tek organizatorët e panairit;
- të marrë në dorëzim kartat e kreditit për blerje me para në dorë;
- të ndërtojë stendën, sipas detyrave të paracaktuara;
- të vendosë materialet reklamuese në stendë;
- të përgatisë tavolinën e prezantimit, gjatë punës në panair;
- të mirëmbajë mjedisin e stendës gjatë panairit;
- të promovojë ndërmarrjen dhe aktivitetin e saj në stendë, nëpërmjet materialeve materialeve të shkruara informative dhe prezantimeve elektronike.
- të promovojë ndërmarrjen ushqimore dhe aktivitetin e saj në sallën e panairit, nëpërmjet bisedave për shitje, reklamimit dhe dhuratave për pjesëmarrësit;
- të lidhë kontrata për blerje dhe shitje për periudha të ardhshme;
- të kryejë blerje për ndërmarrjen dhe personelin me pagesë të mëvonshme dhe karta krediti;
- të kryejë shitjet për personelin dhe vizitorët me arkëtim të mëvonshëm e karta krediti, duke hartuar DL (dëftesa lëvrimi) dhe faturat përkatëse;
- të plotësojë formularin përmbledhës të shitjeve të realizuara në panair;
- të dorëzojë formularin e shitjeve në bankën e firmave.

RM 12 Nxënësi kryen veprime pas panairit

Përmbajtja

- Regjistrimi i blerjeve dhe shitjeve në librat përkatës.
- Regjistrimi në kartelat e magazinës.
- Kryerja e porosive eventuale të firmës korrespondente për kryerjen e blerjeve.
- Kryerja e procedurave të marrjes në dorëzim dhe

- dokumentimit të mallrave të porositura.
- Hartimi i UXH (urdhërshirimet) për blerjet me pagesë të mëvonshme.
- Regjistrimi i arkëtimeve për shitjet me karta krediti.
- Regjistrimi i arkëtimeve eventuale për shitjet me arkëtim të mëvonshëm.
- Llogaritja dhe evidentimi i rezultatit për veprimet e panairit.
- Hartimi i statistikave të shitjeve.
- Analizimi i shitjeve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të regjistrojë saktë blerjet dhe shitjet në librat kontabël përkatës;
- të regjistrojë hyrjet dhe daljet e produkteve në kartelat e magazinës;
- të kryejë porositë eventuale të firmës korrespondente për kryerjen e blerjeve;
- të kryejë procedurat e marrjes në dorëzim dhe dokumentimit të mallrave të porositura;
- të hartojë saktë UXH për blerjet e mëvonshme
- të regjistrojë arkëtimet për shitjet me karta krediti në librat kontabël përkatës;
- të regjistrojë arkëtimet eventuale për shitjet me arkëtim të mëvonshëm në librat kontabël përkatës;
- të llogarisë rezultatit e veprimeve të kryera gjatë panairit;
- të hartojë saktë statistikën, lidhur me shitjet e panairit;
- të analizojë shitjet në panair, krahasuar me shitjet e realizuara në panairin pararendës.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e firmave ushtrimore.
- Trajtimi i këtij moduli duhet të shtrihet gjatë gjithë vitit shkollor. Ai duhet të zhvillohet paralelisht me module të tjera.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet e dokumenteve dhe formularëve të marrë nga praktika e ndërmarrjeve ekonomike, materiale filmike të panairëve të ndërmarrjeve ose dhe të panairëve të viteve të kaluara.
- Mësuesi i praktikës duhet të nxisë aftësitë krijuese të nxënësve duke i nxitur për përdorimin e burimeve të ndryshme të informimit, për një bashkëpunim sa më të mirë me njëri-tjetrin, për realizimin e promocionit të imazhit të ndërmarrjes dhe reklamës së produktit
- Mësuesi i praktikës mund të organizojë vizita në panair të ndërmarrjeve reale, si një përvojë që u vjen në ndihmë nxënësve.
- Mësuesi i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe pajisjeve të firmës ushtrimore.

-
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të kërkuar informacione në treg, krahasuar oferta, kryer dhe regjistruar porosi, kryer blerjet, dokumentimin dhe regjistrimet përkatëse të tyre, për analizimin e klientëve potencialë, nxitjen e mardhënieve me ta, sigurimin e klientëve të rinj, hartimin e kontratave të shitblerjes, kryerjen e shitjeve të drejtpërdrejta dhe në Web-shop, si dhe dokumentimin e regjistrimin e këtyre shitjeve, në përgatitjen e standave, të materialeve të shkruara, të reklamës dhe promocionit, për kryejen e veprimeve dhe bisedave të shitjes në panair si dhe veprimeve të nevojshme pas panairit.
 - Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e politikës së produktit, reklamës për ndërmarrjen dhe produktin, si dhe përgatitjen dhe prezantimin në panair, punën për të kërkuar informacione në treg, krahasuar oferta, kryer dhe regjistruar porosi, kryer blerjet, dokumentimin dhe regjistrimet përkatëse të tyre, analizimin e klientëve potencialë, nxitjen e mardhënieve me ta, hartimin e kontratave të shitblerjes, kryerjen e shitjeve të drejtpërdrejta dhe në Web-shop, përgatitjen dhe paraqitja ne panaire si dhe dokumentimin e regjistrimin e këtyre shitjeve. Përgatitja për panair planifikohet dhe realizohet nga e gjithë klasa.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modurit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- mjediset e firmave ushtrimore,
 - materiale kancelarie,
 - fletëpalosje dhe materiale të ndryshme reklame të marra në ndërmarrje të ndryshme;
 - statistika të panairove të mëparshme të përpunuara nga nxënës të viteve të kaluara;
 - materiale të ndryshme audiovizuale, foto, filma që ilustrojnë paraqitje në panaire të mëparshme; dokumente të ndryshme korrespondence model nga ndërmarrjet reale dhe të përgatitura nga mësuesi,
 - dëftesa lëvrimi, formularë, fatura, regjistra të blerjeve të marra nga praktika ose përpunuar në modulet e mëparshme,
 - kompjuter,
 - materiale të ndryshme informative të marra nga tregu i sektorit.
 - kompiuter i lidhur me internetin dhe me programe të ndryshme animimi dhe të përpunimeve grafike;
-